

-1. Hyrje

1.1 Përshkrimi i projektit

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), kompani kjo në pronësi të plotë të Qeverisë së Kosovës, është duke i zgjeruar operacionet e veta minerare nga minierat sipërfaqësore të Bardhit dhe Mirashit drejt Fushës së Re të Mihjes e cila gjendet në veri të tyre. Faza e parë e zhvillimit të Fushës së Re të Mihjes do të ngërthejë zhvendosjen fizike dhe ekonomike të një pjese të fshatit të Hades – vecanërisht lagjen Shala.

1.1.1 Historiku

Fshati Hade gjendet në Kosovën qendrore, përafërsisht 10 kilometra në perëndim të kryeqytetit – Prishtinës. Ky fshat bën pjesë në komunën e Obiliqit dhe është i lidhur mirë me Obiliqin dhe Prishtinën në kuptim të rrjeteve rrugore dhe sociale, të punësimit dhe tregjeve.

Fshati Hade ndodhet pranë minierave të linjtit Bardh dhe Mirash dhe në fushën e pazhvilluar të koncesionit - Fushën e Re të Mihjes (**Figura 1.1**). Operacionet aktuale në minierat sipërfaqësore të Bardhit dhe Mirashit zhvillohen në distancë prej 125 metrash nga lagjja perëndimore e Hades – Shala. Zhvillimi i Fushës së Re të Mihjes nga KEK-u planifikohet që të fillojë me blerjen dhe transformimin e tokave të zonës së Shalës.

Figura 1.1: Zona e projektit



Zhvillimi i Fushës së Re të Mihjes bëhet në suaza të Projektit për Asistencë Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL), nismë kjo e përkrahur nga Banka Botërore për t'i ndihmuar Qeverisë së Kosovës në joshjen e investitorëve privatë në zhvillimin e minierave të linjitet dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja termale për gjenerim të energjisë elektrike nga linjiti. Në vitin 2007-2008 PATEL-it i është përgatitur Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS), në të cilin identifikohen çështjet strategjike kyçe që ndërlidhen me zhvillimin e linjitet në Fushën e Re të Mihjes, përfshirë këtu edhe çështjet që ndërlidhen me zhvendosjen.

KEK-u dhe Qeveria e Kosovës e kanë kuptuar nevojën e madhe për të zhvendosur popullatën nga zona e Hades. Më 3 nëntor 2004 fshati Hade dhe fshatrat ngjitur në Fushën Mihja e Re shpallen Zonë Interesi Nacional Ekonomik (Vendimi nr. 2157). 158 familje (664 persona) janë evakuuar nga një pjesë e Hades që gjendet në jug të Shalës gjatë një operacioni emergjent në vitet 2004/2005 për shkak të rrezikut nga shembja e tokës.

Në vitin 2008, KEK-u kërkoi iniciimin e vazhdimet të procedurës së shpronësimit për tokat në lokacionin e lagjes Shala.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 08/66 prej dt. 29 Maj, 2009 inicohet procesi i planifikimit të shpronësimit, në koordinim me Zyrën e Projektit Hade pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

Në fund të 2009, si pasojë e këtij vendimi, Qeveria e Kosovës ndërmorri procesin e blerjes së tokës, duke qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, dmth. me Politikën Operacionale të Bankës Botërore për Zhvendosjen e Pavullnetshme 4.12 dhe Standardet e Performancës së Koorporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) mbi Qëndrushmërinë Sociale dhe Mjedisore.

Paralelisht, Qeveria ka inicuar pregaditjen e Kornizës Politike të Zhvendosjes (KPZH) të aplikueshme për Fushën Mihja e Re e Kosovës, duke përfshirë edhe sipërfaqen e fshatit Hade. KPZH është adaptuar nga Qeveria në Korrik, 2011.

Ky Plan i Veprimit për Zhvendosje (PVZH) ka të bëjë ekskluzivisht me zhvendosjen dhe kompensimin e amvisërive dhe me pasuritë dhe veprimtaritë gjegjëse në lagjen Shala. Megjithatë, zhvillimi afatgjatë i Fushës së Re të Mihjes, që pritet të ndodh për më gjatë se 20 vite, do të bëjë të domosdoshëm zhvendosjen e pjesës së mbetur të fshatit Hade e më pastaj edhe të disa lagjeve fqinje. Kësisoj, projekti i zhvendosjes së Shalës është më i rëndësishëm se sa në dukje të parë, pasi që përmes tij do të përcaktohen standardet dhe sistemet që do të shfrytëzohen si shembuj për zhvendosjet tjera që do të kryhen me zhvillimin e mëtejme të fushës së thëngjillit në të ardhmen.

1.1.2 Pasqyra e projektit

Zgjerimi drejt Fushës së Re të Mihjes (apo fushës së linjitet në Sibovc) ka për synim garantimin e një furnizimi të sigurt të thëngjillit për termocentralet ekzistuese dhe të propozuara. Zhvillimi i Fushës së Re të Mihjes do të rezultojë me prodhim prej 15 milione tone në vit, që përbën pothuajse dyfishin e prodhimit nga minierat e Bardhit dhe Mirashit.

Fusha e Re e Mihjes do të zhvillohet me sistem të mihjes sipërfaqësore ndërsa masat e djerrinës do të depozitohen në minierat e Bardhit dhe Mirashit. Zhvillimi i fushës planifikohet të fillojë në pjesën jugperëndimore të fshatit Hade, përfshirë tokën që më parë është blerë nga KEK-u, dhe menjëherë pas kësaj do të shtrihet në zonën e Shalës.

Zhvillimi i minierës në zonën e Shalës do të revoltojë me zhvendosjen fizike dhe ekonomike të amvisërive dhe tokave private që gjenden në hapësirën që do të shfrytëzohet nga Projekti, që përfshin tërë lagjen Shala.

1.1.3 Fushëveprimi i këtij Plani të Veprimit për Zhvendosje

Ky Plan i Veprimit për Zhvendosje përcakton politikat, procedurat, normat, masat lehtësuese dhe kornizën kohore të zhvendosjes dhe kompensimit të Personave të Prekur nga Projekti nga lagja Shala.

Si rezultat i zhvillimit të kësaj faze të planit zhvillimor të minierës do të zhvendosen gjithsej 63 amvisëri dhe 320 banorë të përhershëm, sipas të dhënave nga hulumtimi socioekonomik i vitit 2011. Të gjitha shtëpitë, trojet e kësaj lagjeje, si dhe të gjitha pronat tjera të lokacionit të Hades do të merren, bashkë me të gjithë ahurnjtë, anekset, objektet ekonomike dhe rrugët publike.

Zona e projektit gjithashtu mbulon pronat dhe pasuritë e paluajtshme të rreth 30 amvisërive jo-rezidente, të cilat do të zhvendosen ekonomikisht. Do të blihet edhe e drejta publike e kalimit, që mbahet nga komuna e Obiliqit.

Gjithsej, zona e projektit, që mbulon të dyjat, tokën ndërtimore dhe atë bujqësore, ka 12.4 hektarë.

1.2 Parimet

Parimet vijuese që janë shfrytëzuar për planifikimin e procesit të zhvendosjes së lagjes Shala janë:

1. **Ligjet e Kosovës dhe praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me procesin** – KEK dhe Qeveria e Kosovës janë të përkushtuara që t'u përmbahen të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës që rregullojnë zhvendosjen dhe mbajtjen dhe shpronësimin e tokave, përfshirë Kornizën Politike për Zhvendosje për Fushën e Re të Mihjes (2011). Procesi i planifikimit të zhvendosjes për lagjen e Shalës gjithashtu do të udhëhiqet në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, të cilat rregullohen me Standardet e Politike dhe të Performancës për Qëndrueshmëri Sociale dhe Mjedisore të IFC – në veçanti me Standardin e Performancës 5 mbi Blerjen e Tokave dhe Zhvendosjen Jovullnetare, dhe me Politikën Operative (PO) 4.12 të Bankës Botërore.
2. **Implementimi i një procesi të zhvendosjes i klasit botëror që do të shërbejë si shembull për proceset e ardhshme të zhvendosjes në Kosovë.** Procesi i planifikimit të zhvendosjes për lagjen e Shalës, i cili është dokumentuar në këtë PVZH paraqet një standard për implementimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rregulloreve të miratuara rishtas në Kosovë, përkatësisht Kornizës Politike për Zhvendosje për Fushën e Re të Mihjes. Përderisa në të kaluarën zhvendosjet në Kosovë janë administruar në bazë të masave të shpronësimit, Projekti i Hades është duke u planifikuar dhe do të gjykohet në bazë të standardeve më të larta të zbatueshme në zhvendosje. Pasi që ky do të jetë testi i parë i kësaj kornize të re, politikat dhe procedurat e zhvendosjes që përcaktohen me këtë PVZH (siç janë korniza e autorizimeve, masat e asistencës për grupet e cenueshme) dhe praktikat e ndërlidhura planifikuese (siç është qasja ndaj konsultimeve) do të përbëjnë pikë referimi dhe një standard të ri për proceset e ardhshme të zhvendosjes në Kosovë. Rëndësia që bart ky shembull bëhet edhe më relevante kur kemi parasysh planet për zhvillimin e mëtejshëm të Fushës së Re të Mihjes dhe ndikimet që zhvendosjet do të kenë në më shumë komunitete.
3. **Procesi i planifikimit duhet të udhëhiqet përmes konsultimeve dhe pjesëmarrjes publike në të** – PVZH është produkt i një procesi të planifikimit të zhvendosjes të udhëhequr në bazë të konsultimeve me popullatën më të prekur nga projekti. Për të siguruar një nivel adekuat të

konsultimit dhe pjesëmarrjes, MMPH dhe KEK kanë identifikuar të gjithë individët që duhet zhvendosur dhe i kanë përfshirë ata si palë me interes në një sërë forumesh, përfshirë një sërë takimesh formale të hapura, në grupe specifike të fokusit dhe në një dialog të gjerë joformal. Politikat, procedurat, normat e kompensimit, masat lehtësuese dhe orari i punës që janë përcaktuar në këtë dokument janë produkt i konsultimeve të tilla.

4. **Kompensimi me vlerë zëvendësuese dhe rikthimi i mjeteve të jetesës si minimum** – Ky PVZH i është kushtuar sigurimit të vlerave adekuate për të gjitha pasuritë që preken nga zhvendosja, për të arritur së paku deri te vlera e zëvendësimit (përfshirë shpenzimet e transaksionit) për humbjen e pasurive dhe mundësisë për shfrytëzimin e tyre. Toka, drithërat dhe ndërtesat vlerësohen në lartësinë e zëvendësimit të tyre, pa marrë parasysh moshën apo amortizimin. Janë përgatitur dizajnet e komunitetit dhe shtëpive zëvendësuese, të cilat do t'ia përmirësojnë kushtet e jetesës personave të zhvendosur. Ngjashëm me këtë, ky PVZH dhe aktivitetet e ndërlidhura që kanë të bëjnë me zhvillimin e komunitetit përfshijnë zotimet programatike dhe burimet me të cilat mëtohet të sigurohet përmirësimi apo së paku restaurimi i mjeteve dhe standardit të jetesës së personave të zhvendosur.
5. **Dizajni i kornizës së kompensimit, zëvendësimit të pasurive dhe mjeteve të jetesës duhet të sigurojë përfitime të qëndrueshme** – Programi i zhvendosjes është konceptuar dhe implementuar e, si një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm. Korniza e kompensimit, programet e zëvendësimit të pasurive dhe rikthimit të mjeteve të jetesës në këtë PVZH janë të dizajnuara për të minimizuar ndikimet negative kulturore dhe shoqërore dhe për të siguruar se përfitimet që i gëzojnë personat ekonomikisht dhe fizikisht të zhvendosur janë të qëndrueshme dhe adekuate në aspekt afatgjatë.
6. **Sigurimi i pasurive moderne të zëvendësimit dhe mundësimi i vazhdimësisë së komunitetit** – ky PVZH mëton të sigurojë përmirësime moderne të jetesës së amvisërive të prekura, duke respektuar dhe vlerësuar mënyrat tradicionale të jetesës të cilat janë të rëndësishme për komunitetin. Në këtë kuptim, zhvendosja në fshatin Shkabaj do të sigurojë kushte infrastrukturore dhe të banimit (gjysmëurbane) që përkojnë me ato të Kosovës së shekullit 21. Njëkohësisht, fshati i ri duhet të dizajnohet asisoj që të garantojë vazhdimësinë e komunitetit pas zhvendosjes, aranzhimet e preferuara të jetesës së një amvisërie dhe krijimin e një ndjenje të ngrohtësisë së votrës për të gjithë të zhvendosurit.

2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

2.1 Kosova

2.1.1 Korniza institucionale

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë dy nivele të qeverisjes: niveli kombëtar dhe komunal.

Autoritet kombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës në prill të vitit 2008, e përkufizon shtetin si republikë sekulare, shumetnike dhe demokratike.

Autoritetin ekzekutiv e mbajnë Kryeministri dhe kabineti i ministrave. Kryeministri është shef i qeverisë. Presidenti shërben si shef i shtetit. Edhe Presidenti edhe Kryeministri zgjedhen me vota të Kuvendit të Kosovës.

Autoriteti legjislativ ushtrohet nga Kuvendi i Kosovës. Kuvendi numëron 120 deputetë me mandat katërvjeçar. 100 deputetë zgjedhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërsa 20 ulëse janë të rezervuara për përfaqësues të grupeve pakicë, në pajtim me kuotat e përcaktuara.

Autoriteti gjyqësor ushtrohet nga sistemi i pavarur gjyqësor.

Që nga viti 2011, pas riorganizimit të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për mbikëqyrjen e sektorit të energjisë dhe minierave në Kosovë. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve minerare në Kosovë, përfshirë licencimin dhe zbatimin.

Zyra e Projektit të Hades në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është themeluar në vitin 2004 për të ndihmuar me planifikimin e zhvendosjes dhe evakuimit emergjent në Hade. Qeveria zyrtarisht e ka ngarkuar Zyrën e Hades me udhëheqjen e procesit të zhvendosjes së Shalës në Korrik të 2009 (Vendimi Nr. 09/1627/1).

Autoritet komunale

Territori i Kosovës është i organizuar në komuna për qëllime administrative. Në fillim, në vitin 2001 sistemi i vetëqeverisjes në Kosovë kishte 30 komunal. Që atëherë, Qeveria ka filluar procesin e krijimit dhe përcaktimit të kufijve të tetë komunave shtesë, në pajtim me planet e decentralizimit.

Secila komunë ka kryetar komune dhe kuvendin komunal, të cilët zgjedhen drejtpërdrejt. Funkcionet administrative, siç janë planifikimi, zhvillimi dhe rindërtimi barten nga departamente të ndryshme komunale.

Misionet ndërkombëtare

Misionet përkrahëse ndërkombëtare në vijim vazhdojnë të luajnë rol në administrimin civil dhe sigurinë e Kosovës: Misioni i Administratës së Përkohshme i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe KFOR-i si forcë për Kosovën nën udhëheqjen e NATO-s.

2.1.2 Korniza ligjore

Legjislacioni kyç i zbatueshëm në lidhje me procesin e zhvendosjes të Shalës përfshin Ligjin për Minierat, Ligjin për Shpronësimin dhe Kornizën Politike për Zhvendosje. Procesi i planifikimit të zhvendosjes gjithashtu plotësohet nga rregulloret që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore mbi tokat, shfrytëzimin e tokave, të drejtat e komuniteteve dhe dizajnin e ndërtesave dhe ndërtimin.

Ligji për minierat

Ligji për miniera dhe minerale (03/L-081) u miratua nga Kuvendi i Kosoves në qershor të vitit 2008 për ta ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut për miniera dhe mineral nga viti 2005. Ligji përcakton se licencat për të mihur minerale energjetike mund të lëshohen për periudha jo më të gjata se 30 vite dhe mund të zgjaten edhe për 15 vite tjera.

Neni 13 i Ligjit për miniera dhe minerale ndalon zhvillimin e operacioneve minerare në largësi më të vogël se 200 metra nga kufijtë e fshatrave dhe zonave tjera të banuara dhe më të vogla se 100 metra nga ndërtesat a banimit.

Shpronësimi

Ligji Nr. 03/L-205 duke ndryshuar Ligjin për shpronësimin dhe pronë të paluajtshme (Ligji Nr. 03/L-139) përfshin minierat dhe punimet tjera, eksploatimin e resurseve minerale nga projektet potenciale me interes publik.

Nëse një bartës i licencës së mihjes nuk është në gjendje të hyjë në Marrëveshje për të Drejta Sipërfaqësore me palë të treta në ndërlidhje me programin e tyre të mihjes, Kompania – në pajtim me Ligjin për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme - mund të kërkojë nga Qeveria shpronësimin e të drejtave të kërkuara sipërfaqësore (përndryshe, Ligji për Miniera dhe Minerale lejon KPMM për të aplikuar në emër të bartësit të licencës).

Bartësi i licencës duhet të zotohet që të siguroj dhënien e kompensimit të kërkuar për personat që janë shpronësuar. Neni 15 i Ligjit për Shpronësim përcakton se “Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”

Paragrafi 6 e ngarkon Ministrinë e Financave (MF) me krijimin e metodologjisë së kalkulimit të kompensimit, përmes legjislacionit sekondar, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri, mes tjerash, me parimet apo udhëzimet për kalkulimin e kompensimit që janë nxjerrë apo sugjeruar nga organizatat ndërkombëtare financiare.

Nuk do të bëhet kurrfarë kompensimi për humbjen e ndërtesave, strukturave apo përmirësimeve të tokës nëse:

- Kanë ndodhur pas dorëzimit fillestar të kërkesës për shpronësim ku është kërkuar shpronësimi i pronës së tillë,
- Kanë qenë të ndërtuara në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe
- Nuk kanë qenë në gjendje të legalizohen sipas ligjit të Kosovës në fuqi në datën e vendimit përfundimtar që autorizon shpronësimin e saj.

Megjithatë, specifikisht rregullohet se kompensimi do të paguhet për ndërtesa të shpronësuara që janë ndërtuar ilegalisht në prona të patundshme private nga pronari i pronave, nëse:

- Në datën e ndërmarrjes së veprimtarisë ndërtuese të ndërtesës në fjalë, për pronarin ka qenë e pamundshme të nxjerr leje përkatëse të ndërtimit nga autoriteti komunal, për shkak se në atë kohë nuk ka pasur plan urban apo hapësinor që mbulonte pronën në fjalë; apo
- Në të gjitha aspektet tjera, as ndërtesa as ndërtimi i saj nuk kanë shkaktuar shkelje të ligjeve apo rregulloreve tjera që kanë qenë të zbatueshme atëbotë.

Nëse programi shpronësues i udhëhequr nga Qeveria kërkon shpronësimin e më shumë se 20 parcelave të pronave të patundshme, kompensimi mund të ofrohet:

- Në formë të pronës së patundshme që ka vlerë të barabartë me kompensimin e detyruar; apo
- Në formë të kombinuar të parave të gatshme dhe pronës së patundshme, të cilat së bashku kanë vlerën e barabartë me kompensimin e detyruar.

Shpronësimi konsiderohet të jetë masa e fundit që duhet përdorur nga KEK-u dhe ai ka për synim që të negociojë këtë proces me të gjithë anëtarët e komunitetit të Shalës në mënyrë bashkëpunuese dhe të kënaqshme, siç edhe parashihet në këtë PVZH – gjithnjë duke pasur parasysh se kjo zhvendosje nuk është vullnetare.

Korniza Politike për Zhvendosje

Korniza Politike për Zhvendosje e Republikës së Kosovës për Fushën e Re të Mihjes, e miratuar nga Qeveria e Kosovës në korrik të vitit 2011, përcakton politikat e qeverisë dhe procedurat më të mira të mundshme lidhur me ndikimet e zhvendosjes në lidhje me zhvillimin e Fushës së Re të Mihjes. KPZH është e paraparë të shfrytëzohet si udhëzues për zhvillimin e PVZH të parë për Projektin e Energjisë nga Linjiti, d.m.th. për këtë PVZH, si dhe PVZH-të e mëvonshme. PVZH i detajuar duhet të përgatitet për secilin projekt që rezulton me shpronësim të tokave, zhvendosje fizike të popullatës, humbje të të ardhurave si rrjedhojë e ndryshimit të destinimit të tokave apo qasjes në resurse.

Objektiv i këtij PVZH është të sigurojë se njerëzit do të mund të përmirësojnë apo së paku të rikthejnë standardin e tyre të jetës dhe mjetet e sigurimit të jetesës në periudhën më të shkurtër të mundshme, në çdo rast kur është e pashmangshme kryerja e zhvendosjes apo humbja e asetëve ekonomike dhe mjeteve të jetesës.

KPZH ofron një tabelë të autorizimeve në të cilën identifikohen opsionet e ndryshme të kompensimit dhe zhvendosjes të cilat do t'i ofrohen kategorive të ndryshme të individëve të prekur nga Projekti. Këto politika të autorizimeve shfrytëzohen si bazë e Kornizës së Kompensimit, e cila jepet në Kapitullin 6 të këtij PVZH, dhe specifikisht në tabelën e autorizimeve të dhënë në kaptinën 6.5. PVZH i përmbahet parimit të vlerës së zëvendësimit të të gjitha asetëve të prekura, pa marrë parasysh moshën apo amortizimin.

Marrëveshjet e autorizimeve dhe kompensimeve me amvisëritë e prekura mund të mbulohen me legjislacion sekondar (që duhet miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik) dhe/ose mund të ketë formë të kontratës civile apo marrëveshjes formale mes Kompanisë së Projektit dhe përfaqësuesve të familjeve të prekura.

KPZH përcakton krijimin e mekanizmave të pavarur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilët do të mbulojnë të gjitha aspektet e projektit. Nëse një pronar apo bartës interesi i pronës së patundshme beson me arsye se të drejtat e tij/saj janë duke u shkelur, atëherë, ai person mund të parashtrijë ankesë para gjykatës kompetente, brenda afateve të caktuara kohore (a janë afate sipas ligjit të shpronësimit dhe dërgimi i lëndëve në gjykata).

Prona dhe transaksionet e tokave

Hulumtimet e kadastrave të Hades janë kryer në vitin 2009. Toka është e regjistruar në zyrën kadastrave komunale, dhe për të pronarët individualë apo të pjesshëm mbajnë certifikatat përkatëse të pronësisë.

Bartja e pronës në zonën e Hades kryesisht bëhet përmes shitjes formale apo donacioneve. Trashëgimia e tokave të regjistruara në emër të personave të vdekur zgjidhet përmes proceseve gjyqësore (përfshirë rastet kur të ndjerit i kanë përgatitur testamentet).

Shfrytëzimi i tokave dhe planifikimi i komunitetit

Tokat në Kosovë klasifikohen në bazë të kategorive të destinimit të tyre: në rastin e lagjes Shala, tokat ndahen në ndërtimore dhe bujqësore. Tokat bujqësore ndahen më tej në tetë nënkategori, bazuar në pjellorinë e tyre (I deri VIII). Tokat bujqësore të kategorive I deri IV (tokat më të pëlleshme) mbrohen me Ligjin për Tokën Bujqësore, ndërsa ndërtimi i shtëpive lejohet në tokat e kategorive V deri VIII.

Kategoritë e destinimit të tokave përcaktohen nga Departamenti Komunal i Gjeodezisë, Pronave, Kadastrit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes Mjedisore dhe mund të ndryshohen vetëm me miratimin e Departamentit.

Planet për Zhvillim dhe Parcelizim miratohen nga autoritetet komunale të Kosovës. Në rastin e zhvendosjes në fshatin Shkabaj, autoriteti përkatës është Komuna e Obiliqit. Plani i zhvillimit për miratimin e fshatit të ri është pranuar në vitin 2010; Plani i parcelizimit është miratuar në vitin 2011. Lejet e ndërtimit dhe lejet e shfrytëzimit të ndërtesave gjithashtu duhet të merren nga autoritetet komunale.

Standardet e ndërtimit

Dizajnet e ndërtesave i dorëzohen autoriteteve relevante komunale për rishikim dhe pëlqim. Rregulloret e Kosovës nuk përcaktojnë qartë kushtet e hapësirës (përfshirë madhësinë minimale të dhomave) apo të jetesës në ndërtesa.

2.2 Grupi i Bankës Botërore

2.2.1 Standardet e Performancës të Korporatës Financiare Ndërkombëtare mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore

Në prill të vitit 2006, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) i ka miratuar Standardet e reja të Performancës për Qëndrueshmëri Sociale dhe Mjedisore. Këto Standarde të Performancës (SP) të bazuara në rezultatet e pritshme i kanë azhurnuar politikat ekzistuese të IFC-së, i kanë përforcuar më tej politikat sociale dhe mjedisore dhe kërkojnë ndërmarrjen e vlerësimeve më gjithëpërfshirëse dhe të integruara të ndikimeve. IFC gjithashtu i ka miratuar Udhëzimet përkatëse me të cilat mëton t'i sqarojë kushtet e përcaktuara nga standardet e performancës.

Këto standarde janë të ndara në kaptinat specifike në vijim:

- Standardi i performancës 1: Vlerësimi social dhe mjedisor dhe sistemi i menaxhimit
- Standardi i performancës 2: Puna dhe kushtet e punës
- Standardi i performancës 3: Parandalimi i ndotjes dhe masat mbrojtëse përkatëse

- Standardi i performancës 4: Shëndeti dhe siguria e komunitetit
- Standardi i performancës 5: Përvetësimi i tokave dhe zhvendosja jovullnetare
- Standardi i performancës 6: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore
- Standardi i performancës 7: Popullata vendore
- Standardi i performancës 8: Trashëgimia kulturore.

Për Planin e Veprimit për Zhvendosje më relevantet janë Standardi i performancës 1: Vlerësimi social dhe mjedisor dhe sistemi i menaxhimit dhe Standardi i performancës 5: Përvetësimi i tokave dhe zhvendosja jovullnetare.

Standardi i performancës 1

Standardi i performancës 1 strukturon mënyrën në të cilën do të trajtohen çështjet mjedisore dhe sociale dhe shërben si bazament për standardet tjera. Standardi i performancës 1 kërkon që komunitetet e prekura të angazhohen në mënyrë përkatëse në çështje të cilat potencialisht mund t'i prekin ato. Kushtet kryesore janë në vijim:

- Sigurimi i konsultimeve të lira, paraprake dhe të bazuara në informata adekuate dhe sigurimi i pjesëmarrjes në to
- Fitimi i përkrahjes së gjerë nga komuniteti
- Fokusimi në rreziqet dhe ndikimet negative, dhe propozimi i masave dhe veprimeve për t'i adresuar ato
- Zhvillimi i konsultimeve në mënyrë përfshirëse dhe adekuate nga kuptimi kulturor
- Dizajnimi i procesit për të adresuar nevojat e grupeve të pafavorizuara apo të cenueshme.

Standardi i performancës 5

Standardi i performancës 5 i referohet menaxhimit të zhvendosjes fizike (d.m.th. rilokimit apo humbjes së strehës) dhe zhvendosjes ekonomike (d.m.th. humbja e pasurisë apo qasjes në pasuri që shpie tek humbja e burimeve të të ardhurave apo mjeteve të jetesës) si rezultat i marrjes së tokave për nevoja të projektit. Zhvendosja jovullnetare ndërlidhet me transaksionet ku blerësi kërkon fitimin e qasjes në tokë apo imponimin e kufizimeve në përdorimin e tokës përmes autoriteteve qeveritare.

Standardi i performancës bën përkufizimin e gjerë të personave të zhvendosur, si:

- Persona të cilët kanë të drejta pronësore formale mbi tokën që e shfrytëzojnë
- Persona të cilët nuk kanë të drejta formale pronësore mbi tokën, por të cilët kanë pretendime pronësore të cilat njihen apo janë të njohshme sipas ligjeve të vendit
- Persona të cilët kanë të drejta apo pretendime ligjore të njohshme mbi tokën që e shfrytëzojnë, siç janë ardhacakët oportunistë apo migrantët e ardhur të cilët e zënë tokën para datës së ndërprerjes.

Synimet e Standardit të performancës 5 janë, mes tjerash:

- T'i shmangët apo së paku të minimizohet zhvendosja jovullnetare, duke hulumtuar dizajne alternative të projektit
- Të lehtësojë ndikimet e marrjes së tokës duke ofruar kompensim për humbjen e aseteve, në nivel të zëvendësimit të plotë, dhe të sigurojë se aktivitetet e zhvendosjes do të implementohen duke angazhuar palët me interes në mënyrë adekuate

- Të përmirësojë apo së paku të sigurojë prapë mjetet e jetesës dhe të kthejë standardin e jetës së personave të zhvendosur
- Të përmirësojë kushtet e jetesës së personave të zhvendosur, duke u ofruar atyre vendbanime adekuate dhe të drejta të siguruara pronësore.

Ky standard i performancës:

- Kërkon nga prezantuesit e projektit që të identifikojnë përmes regjistrimit të gjithë personat që duhet të zhvendosen dhe të përcaktojnë një datë të prerjes e cila do të shërbejë për caktimin e kualifueshmërisë së personave për kompensim
- Kërkon nga prezantuesit e projektit që të ofrojnë kompensim me tokë, kurdo që kjo është e arsyeshme, për të gjitha rastet kur personat e zhvendosur varen nga tokat dhe në rastet kur toka është në pronë kolektive
- Sugjeron zbatimin e standardit të performancës në situatat kur zhvendosja që nuk është e ndërlidhur me marrjen e tokave ka ndodhur për shkak të ndikimeve negative ekonomike, sociale apo mjedisore të aktiviteteve të projektit
- Paraqet konceptin e marrëveshjeve të negociuara për t'iu shmangur largimit të dhunshëm të popullatës
- Kërkon nga kompanitë e sektorit privat që të mbulojnë zbrazëtirën mes kushteve ligjore vendore dhe kushteve të standardit të performancës
- Inkurajon bashkëpunim në minimizimin e rreziqeve dhe kërkon nga propozuesit e projektit që të mbulojnë boshllëqet në kompensim në rastet kur qeveria merr projektet e tilla nën udhëheqje
- Kërkon përgatitjen e Planit të Veprimit për Zhvendosje, me të cilin demonstron se si do të menaxhohet zhvendosja, në pajtim me standardin e performancës.

Më tej, standardi i performancës 5 kërkon që standardet e kompensimit të jenë transparent dhe të njëtrajtshëm për tërë projektin, dhe të jenë të caktuara me pjesëmarrjen e personave të prekur.

Propozuesit e projektit duhet, sipas këtij standardi të performancës, t'u ofrojnë personave dhe komuniteteve të zhvendosura kompensim për humbje të asetëve, në masë e cila u mundëson zëvendësimin e tyre, dhe t'u ndihmojë në përmirësimin apo së paku në kthimin e nivelit të standardit të jetesës dhe mjeteve të jetesës. Vlera e zëvendësimit të pasurive përkufizohet si në vijim:

- **Toka bujqësore:** vlera e tregut e tokës që ka produktivitet të njëjtë apo tokave që gjenden në afërsi të tokës së prekur, plus kostoja e përgatitjes së tokës për të arritur nivelin e tokës së prekur apo për ta tejkalluar atë, plus kostoja e të gjitha taksave të regjistrimit dhe bartjes;
- **Toka në zona urbane:** vlera e tregut e tokës së sipërfaqes dhe destinimit të njëjtë, me stabilimente të ngjashme apo më të mira të infrastrukturës publike dhe shërbimeve, preferohet të ndodhet në afërsi të tokës së prekur, plus kostoja e të gjitha taksave të regjistrimit dhe bartjes;
- **Strukturat banesore dhe publike:** Kostoja e blerjes apo ndërtimit të një strukture të re, me sipërfaqe dhe cilësi të ngjashme apo më të mirë se sa ato të prekurat, apo kostoja e riparimit të një strukture pjesërisht të prekur, përfshirë pagimin e punës dhe kontraktorëve dhe të të gjitha taksave të regjistrimit dhe bartjes.

Gjatë përcaktimit të kostos së zëvendësimit, amortizimi i asetit në fjalë dhe vlera e materialeve përkatëse që mund të ruhen nuk merren parasysh, sikur që nuk merret parasysh as vlera e përfitimeve që do të vijnë nga projekti, të cilat nuk guxojnë t'i zbriten vlerës së asetit të prekur.

Në rastet kur ligjet dhe politikat kombëtare nuk parashohin kompensimin në vlerë të plotë të zëvendësimit, apo kur ekzistojnë boshllëqe tjera mes ligjeve apo politikave kombëtare dhe kushteve të përcaktuara për personat e zhvendosur, standardi i performancës këshillon që propozuesit e projektit të

shqyrtojnë edhe masa alternative për të arritur synimet që janë në pajtueshmëri me objektivat e standardit të performancës në fjalë (p.sh. sigurimi i mjeteve shtesë në para të gatshme apo në natyrë).

Në rast të zhvendosjes fizike të personave, ky standard i performancës kërkon që propozuesit e projektit të ofrojnë pronë zëvendësuese të vlerës së njëjtë apo më të lartë, me karakteristika të njëjta apo më të mira dhe me përparësi sa i përket lokacionit, sigurisë pronësore; apo kompensim në para të gatshme në vlerë të plotë të zëvendësimit, kurdo që kjo është e mundur.

Nëse marrja e tokës për qëllime të projektit shkakton humbje të të hyrave apo mjeteve të jetesës, pa marrë parasysh nëse personat e prekur janë zhvendosur fizikisht apo jo, nga propozuesit e projektit kërkohet:

- Që me shpejtësi t'i kompensojnë personat e zhvendosur ekonomikisht për humbjen e aseteve apo qasjes në asete, në vlerën e plotë të zëvendësimit
- Në rastet kur marrja e tokës ka ndikim në strukturat komerciale, që t'ia kompensojnë pronarit të biznesit shpenzimet për rihapjen e veprimtarisë afariste gjetiu, fitimet neto për periudhën gjatë tranzicionit, dhe shpenzimet për bartjen dhe riinstalimin e stabilimenteve, makinerisë dhe pajisjeve tjera
- Të ofrohet pronë zëvendësuese (p.sh. hapësira bujqësore apo afariste) të vlerës së njëjtë apo më të lartë, apo kompensim me para të gatshme në vlerën e plotë të zëvendësimit, kurdo që kjo është e mundur, për personat të cilët kanë të drejta apo pretendime ligjore mbi toka të cilat janë të njohura apo të njohshme sipas të drejtës së vendit
- Që t'i kompensojnë personat e zhvendosur ekonomikisht të cilët nuk kanë të drejta ligjore për humbjen e pasurisë së tyre (siç janë të mbjellat, infrastruktura e ujitjes, dhe përmirësimet tjera që i kanë bërë tokës), përveç për tokën, në vlerë të plotë të zëvendësimit
- Që të ofrojnë asistencë për grupe të caktuara (p.sh. kredi, trajnime, apo mundësi punësimi) dhe mundësi për të përmirësuar apo së paku për të rikthyer kapacitetin për të fituar të hyra, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës për personat e zhvendosur mjetet e jetesës dhe niveli i të hyrave të të cilëve është ndikuar negativisht
- Të ofrohet përkrahje tranzitore për personat e zhvendosur ekonomikisht, sipas nevojës, bazuar në një vlerësim të arsyeshëm mbi kohën e kërkuar për të rikthyer kapacitetin e tyre për të gjeneruar të ardhura, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës.

2.2.2 Politika Operative 4.12 e Bankës Botërore

Politika operative 4.12 e Bankës Botërore u azhurnua në mars të vitit 2007. Kjo PO përfshin masa mbrojtëse për adresimin dhe pakësimin e rreziqeve nga varfërimi si rezultat i zhvillimit të projektit dhe zhvendosjes jovullnetare.

PO 4.12 adreson ndikimet e drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale që rezultojnë nga projektet investuese të Bankës, si rrjedhojë e marrjes së tokës në mënyrë jovullnetare (që rezultojnë me rilokim apo humbje të strehës, aseteve apo qasjes në asete dhe/ose humbje të burimeve apo mjeteve të jetesës) apo nga kufizimi jovullnetar i qasjes në zona të mbrojtura me ligj që rezultojnë me ndikime negative në jetët e personave të prekur.

PO përcakton tri synime të përgjithshme:

- Zhvendosja jovullnetare duhet shmangur kurdo që kjo është e mundur; apo të minimizohet duke shqyrtuar të gjitha mundësitë tjera alternative për projektin.
- Kurdo që nuk është e mundur që t'i shmangemi zhvendosjes, aktivitetet e ndërlidhura me zhvendosje duhet paraparë dhe ekzekutuar në formë të programeve të qëndrueshme zhvillimore, duke ofruar burime të mjaftueshme investuese për t'i mundësuar personave të

zhvendosur nga projekti që t'i gëzojnë përfitimet nga ai. Personat e zhvendosur duhet të konsultohen dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në planifikimin dhe implementimin e programeve të zhvendosjes.

- Personave të zhvendosur duhet t'u ndihmohet praktikisht në përpjekjet e tyre për të përmirësuar mënyrën e jetesës dhe standardin e jetesës, apo së paku për të rikthyer standardin e jetesës në nivelin para zhvendosjes apo në nivelin e përgjithshëm nëse ai nivel është më i lartë.

Propozuesi i projektit është përgjegjës për përgatitjen, implementimin dhe monitorimin e planit të zhvendosjes (apo kornizës politike për zhvendosje) me të cilin në mënyrë adekuate dokumentohet procesi i planifikimit të zhvendosjes dhe masat për të cilat është arritur pajtueshmëri.

Sipas PO 4.12, implementimi i aktiviteteve të zhvendosjes është i ndërlidhur me implementimin e komponentit investues të projektit me të cilin sigurohet se zhvendosja apo kufizimi i qasjes nuk do të ndodh para se masat e domosdoshme të zhvendosjes të jenë realizuar. Specifikisht, marrja e tokës dhe aseteve që ndërlidhen me shfrytëzimin e tokave mund të ngjan vetëm pasi që të jetë kryer kompensimi dhe pasi që lokacionet në të cilat do të bëhet zhvendosja dhe pagesat përkatëse për bartje atje t'u jenë siguruar personave të zhvendosur.

3. KUSHTET EKZISTUESE

Në këtë kapitull paraqiten kushtet ekzistuese në zonën e projektit dhe përreth saj, me theks të veçantë në zonën që do të preket nga zhvillimet e lagjës Shala.

3.1 Metodologjia

Më 2011, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me ndihmë nga autoritetet komunale dhe konsulentët përkatës, kreu një regjistrim gjithëpërfshirës, një hulumtim socioekonomik dhe një regjistrim të pasurive të patundshme, të dhënat nga të cilat do t'i shfrytëzojë për të kuptuar se cila është gjendja bazike në zonën e prekur nga projekti. Përveç kësaj, hulumtimi i pasurive të patundshme ka shërbyer si bazament për negociatat e kompensimit me ekonomitë familjare.

Gjatë hulumtimit në terren, ekipi hulumtues u takua me të gjithë kryefamiljarët apo përfaqësuesit e deleguar. Ekipi hulumtues organizoi një orar fleksibil të veprimtarisë hulumtuese për të garantuar pjesëmarrje publike. Dokumentet e regjistrimit dhe hulumtimit janë nënshkruar nga personat që kanë dhënë informatat. Regjistrat e asetëve dhe të dhënave socioekonomike më pastaj janë shqyrtuar dhe janë validuar bashkë me kryefamiljarët (dhe anëtarët tjerë). Kopjet e të dhënave nga regjistrat u janë siguruar të njëjtëve.

Qëllimi i regjistrimit dhe hulumtimit ishte që:

- Të identifikohen të gjithë anëtarët e familjeve të prekura, përfshirë numrin e banorëve në momentin hulumtimit;
- Të mësohet numri, moshja, gjinia, marrëdhëniet, të hyrat dhe profesionin e të gjithë personave në çdo amvisëri, të cilat do të shfrytëzohen në sajimin e të dhënave socioekonomike për monitorim dhe vlerësim të statusit të personave të prekur në të ardhmen;
- Për të vlerësuar gjendjen ekonomike të secilës ekonomi familjare, në mënyrë që të identifikohen burimet e të hyrave të cilat mund të preken nga zhvillimi i projekteve, por edhe mundësitë për burime të reja të të ardhurave, si dhe ndihmimin e identifikimit të grupeve të cënueshme të cilave u nevojitet ndihmë asistence.
- Për të sajuar një regjistër të pronave të patundshme dhe personale dhe të amvisërive të prekura nga zhvendosja dhe përcaktimi i buxhetit për kompensimin e tij;
- Për të vlerësuar madhësinë, kushtet, materialet ndërtimore dhe dizajni i strukturave të fshatrave, për të caktuar kriteret e dizajnit për komunitetin e ri të të zhvendosurve, i cili duhet të plotësojë nevojat e amvisërive të prekura dhe të jetë i dëshirueshëm prej tyre.

Vlerësimi i kushteve socioekonomike në Shalë është përkrahur nga të dhënat cilësore dhe sasiore të grumbulluara për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) të përgatitur në vitin 2008 për PATEL-in për zhvillimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit dhe bartjes dhe për zhvillimin e fushës së re të mihjes.

3.2 Konteksti nacional

Republika e Kosovës është shtet i vetëshpallur i pavarur në Evropën juglindore. Është shtet pa dalje në det dhe kufizohet me Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë. Kosova ka fusha të gjera dhe male të larta, qytete të orientura nga perëndimi dhe fshatra të largëta rurale, në gjithsej 10,887 km².

Politikisht dhe administrativisht, Kosova gjendet në tranzicion. Pavarësia është shpallur më 17 shkurt të vitit 2008 dhe është njohur nga mbi 80 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kosova gjithashtu është anëtare e Bankës Botërore dhe IFC.

Popullata e Kosovës prej rreth 2 milion banorë rangohet si një nga më të rejtat dhe me rritjen më të shpejtë në Evropë (mosha mesatare është 27 vjeç). Nivelet e larta të emigrimit dhe rënia e normave të natalitetit paralajmërojnë ngadalësim gradual të kësaj rritje. Një evolucion tjetër që ndodh në balancin e popullatës urbane-rurale, duke qenë se qytetet e Kosovës, veçanërisht Prishtina, po zgjerohen në masë të madhe, pjesërisht për shkak të shtimit të fluksit të popullatës rurale, e pjesërisht nga kthimi-migrimi dhe investimet nga donatorët dhe Kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Popullata e vendit përbëhet nga shumica shqiptare dhe komunitetet tjera të rëndësishme pakicë, të cilat gëzojnë të drejta të veçanta elektorale përfshirë Ashkalinjtë, Boshnjakët, Egjiptianët, Goranët, Romët, Serbet dhe Turqit

Edhe pse me dhjetëra mijëra janë kthyer, shumë Kosovarë nga të gjitha komunitetet ende kanë mbetur jashtë Kosovës, megjithëse kanë të drejta ligjore (përfshirë të drejtat pronësore mbi tokat dhe ndërtesat) në Kosovë. Zhvendosja e brendshme gjithashtu ka mbetur çështje e pazgjidhur për shumë amvisëri dhe paraqet një çështje me pasoja të theksuara sociale dhe ekonomike dhe është veçanërisht akute tek komunitetet pakicë.

Edhe pse Kosova ka shënuar rritje makroekonomike që nga fundi i konfliktit në vitin 1999 – përfshirë edhe periudhën e krizës globale të fundit – papunësia dhe varfëria mbeten sfida në këtë vend që është një nga shtetet më të varfra të Evropës. Punësimi dhe pjesëmarrja në treg të punës janë jashtëzakonisht të ulëta, ngase vetëm 53 për qind e fuqisë punëtore është e angazhuar aktivisht në treg të punës ndërsa vetëm 29 për qind janë të punësuar (Banka Botërore 2011). Në anën tjetër, 45 për qind jetojnë nën kufi të varfërisë ndërsa 17 për qind supozohet se janë nën kufirin e varfërisë ekstreme (të paaftë për të mbuluar nevojat themelore të të ushqyerit) (Banka Botërore 2011).

Ekonomia e Kosovës mbetet ende tejet e varur në shpenzime publike, aktivitete donatorësh dhe remitanca, ndërsa që eksportet kanë një kontribut tejet të vogël. Banka Botërore ka identifikuar sektorët e mihjes dhe energjisë si burime potenciale kryesore të rritjes në vend, duke e marrë parasysh se Kosova ka burime të mëdha të linjtit, hekurit, zinkut, feronikelit, magnetitit, dhe gurëve të thyer, si dhe gasje relativisht të lirë dhe të papenguar në tregjet evropiane.

Rezervat e linjtit në Kosovë janë përafërsisht 10,000 mt, që paraqet një nga depozitat më të mëdha të tilla të botë. Aktualisht, prodhimtaria e energjisë elektrike në vend varet në masë të gjerë (97%) nga djegia e linjtit në termocentralet Kosova A dhe Kosova B pranë Obiliqit (Kosova nuk ka infrastrukturë të furnizimit të gazit apo rafineri të naftës dhe i importon të gjitha lëndët djegëse të lëngshme). Duke qenë se këto termocentralet janë duke iu afruar fundit të jetëgjatësisë së tyre (që pritet të përfundojë në vitin 2017, respektivisht 2030), KEK-u është duke e realizuar zgjerimin e planifikuar të infrastrukturës energjetike në vend, përfshirë ndërtimin e një termocentrali të ri – Kosovës se Re – dhe zgjerimin e fushës ekzistuese të linjtit drejt Fushës së Re të Mihjes.

3.3 Konteksti komunal

Projekti ndodhet në komunën e Obiliqit/Kastriotit, në Kosovën qendrore. Kjo komunë i është ndarë komunës së Prishtinës në vitin 1989 dhe është një nga komunat më të vogla në vend. Popullata e kësaj komune numëron rreth 30,000 banorë dhe është një nga popullatat më të dendura.

Komuna karakterizohet me fushat e Rrafshit të Kosovës, të cilat përshkohen përmes nga lumi Sitnicë dhe kufizohen në perëndim me relief kodrinor-malor. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së kësaj komune i është dedikuar shfrytëzimit bujqësor, kryesisht për kultivimin e grurit, misrit dhe patateve. Megjithatë, prezenca e konsiderueshme industriale, përfshirë minierat e Bardhit dhe Mirashit, deponitë e djerrinës dhe termocentralet kryesore në vend (Kosova A dhe B), dhe zona e zgjeruar urbane bëjnë që kjo komunë të ketë një peizazh gjysmëurban- gjysmërrural.

Qendra e komunës Obiliqi ndodhet mbi korridorin kryesor hekurudhor të Kosovës dhe në territorin e tij ndodhen termocentralet aktuale Kosova A dhe B si dhe ai i propozuar Kosova e Re. Shërbimet shëndetësore, arsimit mesëm dhe shërbimet tjera publike dhe profesionale për këtë rajon janë të centralizuara në Obiliq. Lidhjet rrugore dhe të transportit drejt viseve rurale janë në përmirësim e sipër. Megjithatë, shumë fshatra vazhdojnë të mos kenë sisteme adekuate të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Mihja e linjitet në Obiliq zhvillohet që nga vitet e 20ta të shekullit të kaluar. Zgjerimi i theksuar i mihjes sipërfaqësore dhe ndërtimi i Kosovës A kanë filluar në vitet e 60ta. Sot KEK-u është punëdhënësi më i madh në këtë komunë. Rrjedhimisht, fati ekonomik i komunës varet nga operacionet e KEK-ut, qoftë nga zvogëlimet në fuqi punëtore që kanë ndodhur në të kaluarën qoftë nga zgjerimi i planifikuar në të ardhmen. Gjendja mjedisore dhe shëndetësore në këtë zonë është tejte e ndikuar nga dy termocentralet dhe nga operacionet minerare të zhvilluara pothuajse përgjatë tërë komunës.

3.4 Zona e ndikimit të projektit

3.4.1 Modelet e zhvendosjes

Lagja e Shalës përfshin krahun perëndimor të fshatit Hade dhe ndodhet në rrëpirat e kodrës menjëherë në veri të minierave të Bardhit dhe Mirashit.

Kjo lagje ka sipërfaqe prej 12.4 ha. Ajo përbëhet nga parcela të ngushta rezidenciale, të cilat shtrihen përgjatë rrugës së paasfaltuar në drejtim lindje-perëndim. Shtëpitë janë shpesh të grupuara në njësi të rrethuara me mure dhe ndodhen më afër rrugës, ndërsa njësitë ndihmëse, kopshtet, tokat bujqësore dhe kullosat gjenden më në veri. Me kalimin e kohës, pronat janë ndarë brenda familjeve. Pothuajse të gjitha familjet e kësaj lagjeje kanë mbiemrin Shala.

Tokat e “Zonës emergjente” që tani janë të zbrazëta pas evakuimit të viteve 2004/2005 gjenden menjëherë në jug të Shalës. Xhamia dhe shkolla fillore vendore gjenden në lindje të fshatit Hade dhe nuk mbulohen nga Zona e ndikimit të Projektit. Shumica dërmuese e banorëve furnizohen në qendër të Obiliqit.

3.4.2 Demografia

Lagja Shala përbëhet nga 63 amvisëri me gjithsej 320 banorë (sipas vlerësimit socioekonomik të vitit 2011). Përveç kësaj, 30 struktura tjera ndërtimore dhe prona në Shalë u përkasin pronarëve që banojnë diku tjetër në Kosovë (kryesisht në Obiliq apo Prishtinë) apo jashtë vendit. Disa nga këta

pronarë i mbajnë këto shtëpi si shtëpi sekondare apo si vende ku do të qëndrojnë kur t'i vizitojnë të afërmit e tyre. Në përgjithësi, të prekur nga projekti janë 510 persona (sipas vlerësimit socioekonomik të vitit 2011).

Shumica e popullatës së përhershme është nën moshën 29 vjeçare, ndërsa dy grupmoshat më të mëdha janë ato mes 10-19 dhe mes 20-29 (**shih Tabelën 3.1**). Në përgjithësi, popullata është e baraspeshuar në aspektin gjinor, megjithëse vërehet një jobaraspeshë tek të rriturit e rinj: numri i femrave në krahasim me numrin e meshkujve në moshën 10-29 vjeçare është në raport pothuajse 3-2.

Tabela 3.1: Ndarja e popullatës së prekur nga projekti sipas moshës

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Total
0-9	50	41	91
10-19	50	48	98
20-29	46	68	114
30-39	41	36	77
40-49	29	27	56
50-59	22	15	37
60-69	8	12	20
70+	12	5	17
Total	258	252	510

3.4.3 Mjetet e jetesës

Amvisëritë në Shalë shfrytëzojnë forma të ndryshme për të siguruar jetesën, përfshirë punët me pagë, punën e kohëpaskohshme, përkrahjen nga shteti dhe familja dhe aktivitetet bujqësore ndihmëse (**Tabela 3.2**). Në shumicën e rasteve, amvisëritë kanë më shumë se një burim të të ardhurave. Duke qenë se janë pjesë e një ekonomie gjysmëurbane dhe kanë sipërfaqe të kufizuara të tokës në zonën e Hades, asnjë amvisëri nuk ka raportuar se fiton të ardhurat nga aktivitetet bujqësore.

Tabela 3.2: Burimet e të ardhurave

Burimi i të ardhurave	# të amv.	%
Punësimi i përhershëm	64	69%
Vetëm remitancat	10	11%
Vetëm punësimi i kohëpaskohshëm	6	6%
Vetëm pensionet	4	4%
Tjera	9	10%

Punësimi me pagesë, do të thotë punësimi i përhershëm, paraqet burimin më të madh të të ardhurave në shumicën e amvisërive. Në gjithsej 64 nga 93 amvisëritë e anketuara u tha se pjesa më e madhe apo të gjitha të ardhurat e tyre vinin nga pagat e tyre të rregullta. Të ardhurat mesatare nga punësimi i përhershëm ishin rreth 600 euro në muaj. Punësimi i kohëpaskohshëm apo jo i rregullt ishte më rrallë bazë e të hyrave por u përmend si burim i të ardhurave në 6 amvisëri.

Nga numri i gjithmbarshëm i popullatës së prekur 96 individë ishin të punësuar në kohën e zhvillimit të anketës socioekonomike (**Tabela 3.3**). 39 burra dhe 5 gra ishin të punësuar në KEK, që përbëjnë 46% të të gjithë të punësuarve në lagjen Shala.

Tabela 3.3: Statusi i punësimit

Grupmosha	Meshk.	Femra	Total
Aktiv në tregun e punës	115	22	135
Norma e pjesëmarrjes (18-65)	96%	17%	55%
Të punësuar	79	19	96

Të përhershëm	67	19	86
Të vetëpunësuar	4	0	4
Të përkohshëm	6	0	6
Të papunësuar	36	3	39
Norma e papunësisë	31%	14%	28%

Më tej, 39 persona e kanë identifikuar veten si persona të papunësuar që aktivisht kërkojnë punë. Norma e ulët e pjesëmarrjes në treg të punës dhe norma e lartë e papunësisë prej 28% nuk përbën përjashtim nga gjendja e përgjithshme me punësimin në Kosovë.

Nga 130 gra mes moshës 18 dhe 65 vjeçare që nuk janë duke u shkolluar, vetëm 22 kanë raportuar të jenë aktive në tregun e punës (të punësuara apo të papunësuara) ndërsa vetëm 19 kanë dhënë se kanë punësim të përhershëm.

Burime tjera të të ardhurave luajnë rol kyç për jetesën në amvisëritë e Shalës, përfshirë këtu remitancat nga anëtarët e familjes me qëndrim jashtë vendit, pensionet dhe pagesat e ndihmës sociale. 19 amvisëri (20%) kanë raportuar se marrin ndihmë financiare nga anëtarët e familjes që gjenden jashtë vendit, në formë të remitancave. Vlen të theksohet se 10 familje i kanë identifikuar remitancat si të vetmet burime të të ardhurave. Remitancat që këto familje marrin janë mesatarisht 200 euro në muaj.

Asnjë amvisëri në Shalë nuk angazhohet në bujqësi për profit. Në vend të kësaj, aktivitetet bujqësore shihen si ndihmesë (shtesë) për sigurimin e ushqimit dhe burimeve për amvisëritë. Sipas të dhënave nga hulumtimi socioekonomik i vitit 2011, 66 amvisëri në pronat e tyre rrisin pemë e perime për konsum brenda amvisërisë. Vetëm 10 amvisëri kultivojnë të mira jashtë kopshtit apo vreshtës së tyre.

Të hyrat mesatare për amvisëri në Shalë brenda komunitetin shënojnë luhatje të theksuara, duke qenë se 34% kanë raportuar se të hyrat i kanë më të vogla se 250 euro në muaj (**Tabela 3.4**).

Tabela 3.4: Të ardhurat mujore të amvisërisë

Të ardhurat mujore të amvisërisë	Total	%
Mbi 750 euro	19	20%
500 – 750 euro	6	6%
250 – 500 euro	36	39%
100 – 250 euro	25	27%
Nën 100 euro	7	8%

3.4.4 Gjendja sociale

Shëndetësia

Në zonën e prekur nga projekti (dhe në Hade) nuk ka asnjë klinikë mjekësore dhe asnjë farmaci. Banorët janë të detyruar që të shfrytëzojnë qendrat e shëndetit publik apo klinikat private në Obiliq apo në Prishtinë (për raste të trajtimit të specializuar).

Arsimi

Pjesa më e madhe e popullatës së rritur të prekur nga projekti në Shalë i kanë të kryera së paku tetë vite të shkollimit fillor (95%), përfshirë këtu edhe 93% të femrave (**Tabela 3.5**). Numri i femrave që kanë vazhduar dhe përfunduar shkollimin e mesëm është më i ulët se sa i meshkujve (59% kundrejt 89%). 98% të popullatës deklarohet se din shkrim-lexim.

Tabela 3.5: Shkollimi

Edukimi	Meshk.	Femra	Total
Pa shkollim formal	3%	7%	5%
Filllore të kryer (5-8 vite)	97%	93%	95%
Të mesme të kryer (10-13 vite)	89%	59%	73%
Diplomë universitare	2%	3%	3%

Shkolla fillore në Hade (që nuk bie nën zonën e prekur nga projekti në këtë fazë) shfrytëzohet edhe nga nxënësit e Shalës. Për ta vazhduar shkollimin e mesëm, nxënësit duhet të udhëtojnë në Obiliq.

3.4.5 Banimi

Shumica e objekteve të banimit në zonën e prekur nga projekti kanë konstruksion të tullave të argjilës, me murre të brendshme dhe të jashtme të veshura me llaq dhe suva.

Ka pasur ndërtime të reja të vërejtshme, prej Shpalljes Zone Interesi Nacional në nëntor, 2004. Ndërtimet e tilla sfidojnë Shpalljen (ndërtimet e reja kanë mbetë në Zonën e Interesit) dhe janë ndërtuar pa leje ndërtimi nga Komuna. Ndërtimet e reja kryesisht janë si shtëpi të ndërtuara në toka bujqësore, gjithsej 40 shtëpi. Këto struktura të reja duket se janë ndërtuar për qëllime spekulative. Shumica e këtyre strukturave ose nuk janë të banuara fare ose nuk janë plotësisht të banueshme – shumica e tyre kanë mungesë izolimi, themele të paqëndrueshme dhe lavamanet dhe tubacionet e instaluar në shtëpi nuk janë të lidhura me Sistemin Komunal të Ujësjetës apo ndonjë burim tjetër të ujit.

Për dallim, të gjitha shtëpitë që posedojnë leje janë të lidhura në sistemin elektroenergjetik dhe kane furnizime te ujit nga ujesjellsi komunal.

Më shumë se gjysma e shtëpive kanë pranë tyre kopshte dhe pemishte të vogla në të cilat i kultivojnë pemët dhe perimet për nevoja vetanak. Disa shtëpi kanë të ndërtuara pranë tyre shtëpizat e shfrytëzuara nga kafshët shtëpiake.

3.4.6 Infrastruktura dhe stabilimentet

Çdo shtëpi e banuar e Shalës është e lidhur me rrjetin elektroenergjetik. Të gjitha janë të furnizuara me ujë nga sistemi i ujesjellesit komunal, megjithëse, ceshtja e shtypjes se ujit ne sistem ndonjehere e ndalon furnizimin. Komuna pohon se banoret ne Shala nuk jane te ngarkuar te paguajne per konsumimin e tyre te ujit, per dallim nga shume komunitete urbane ne rajon. Përafërsisht gjysma kanë lidhje në ndonjë formë të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, kryesisht në formë të gropave septike.

95% të shtëpive kanë frigoriferë dhe 89% kanë makina të larjes. Vetëm 11% kanë telefona në shtëpi, ndërsa pothuajse 55% kanë qasje në internet.

Asnjë shtëpi nuk ka kaldajë për ngrohje qendrore. Ngrohja bëhet me stufa apo me ngrohëse të hapësirave.

3.4.7 Mjedisi

Mjedisi i jetesës në Shalë ndikohet nga operacionet minerare që bëhen menjëherë pranë lagjes, në kuptim të ndikimeve të dukshme, pluhurit, zhurmës dhe ndotjes së ajrit. Siç ndodh edhe me lagjet tjera të vogla në këtë rajon, Shala gjithashtu vuan nga ndotja që shfaqet si rezultat i mostrajtitimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta.

4. NDIKIMET E MARRJES SË TOKAVE

4.1 Udhëzimet e IFC-së

Udhëzimet e IFC-së theksojnë se “planifikimi i zhvendosjes ngërthen në vete më shumë se kryerje të vëzhgimeve kadastrave apo regjistrimit të pasurive të prekura”. Një detyrë kyçe gjatë planifikimit të zhvendosjes është “identifikimi i ndikimeve negative të projektit dhe popullatës që do të preket nga ai”.

4.2 Përpyjekjet për të minimizuar zhvendosjen

Studimet hulumtuese kanë identifikuar rezerva të konsiderueshme të linjtit në Fushën e Re të Mihjes. Fshati Hade dhe lagja Shala gjenden në cepin jugor të Fushës së Re të Mihjes, menjëherë pranë minierës ekzistuese të Bardhit/Mirashit. Pjesa më e madhe e lagjes së Shalës, si dhe tokat rurale në veri dhe perëndim (që më parë janë blerë nga KEK-u), gjenden në zonën e propozuar për zgjerim të fushës gjatë fazës së parë.

Aktualisht, pjesa më e madhe e lagjes Shala konsiderohet të rrezikohet nga shembjet, për shkak të afërsisë me cepin e minierës dhe operacioneve të ndërmarra në Bardh. Disa prona të banimit gjenden në afërsi më të vogël se 200 metra nga cepi i minierës – që paraqet shkelje të dispozitave të Ligjit për Miniera dhe Mineral lidhur me zonat mbrojtëse.

Janë shtjelluar alternativa të dizajnit të projektit të cilat do të minimizonin marrjen e tokave gjatë fazës së parë, duke lënë të paprekur pjesët e lagjes që nuk bien në zonën që do të preket nga faza e parë e zhvillimit. Megjithatë, kjo fazë fillestare e përpunimit të trupit të xeheve do ta linte pranë aktiviteteve minerare pjesën tjetër të popullatës (më pak se një kilometër larg) dhe do të ndikonte potencialisht në sigurinë dhe shqetësimin e tyre, duke i lënë të jetojnë në kushte të ngjashme me ato me të cilat sot përballet lagja e Shalës.

Përveç kësaj, gjatë konsultimeve me liderët dhe pjesëtarët e komunitetit të Shalës është vendosur se lagja Shala do të zhvendoset si një tërësi (**shih kaptinën 5.4.1**). Liderët dhe pjesëtarët e komunitetit e kanë identifikuar zonën gjeografike që ata konsiderojnë se përbën lagjen Shala, duke i ndarë pronat që mbahen nga amvisëritë që janë në lidhje familjare. Kjo kërkesë është pranuar formalisht nga KEK-u dhe MMPH.

Kjo strategji është në pajtim me synimin për rikrijimin e komunitetit përmes zëvendësimit të pasurive në natyrë në një fshat të ri ku do të realizohet zhvendosja, dhe i ndihmon mbajtjes së rrjeteve ekzistuese kulturore dhe sociale. Theksi në kompensimin në natyrë gjithashtu ndihmon minimizimin e rreziqeve që ndërliken me kompensimin në para të gatshme, në kuptim të krijimit të kushteve adekuate të jetesës dhe të mjeteve të qëndrueshme për sigurim të jetesës.

Banorët e Shalës, në bashkëpunim me KEK-un dhe MMPH-në, e kanë pranuar lokacionin ku do të kryhet zhvendosja në Shkabaj, që ndodhet më afër se 10km nga fshati ekzistues (**shih kaptinën 7.2**). Kjo afërsi do duhej të mundësojë sadopak ruajtjen e praktikave ekzistuese sociale, afariste dhe të punës, pa u dashur të udhëtohet në distanca të largëta. Lokacioni i ri gjithashtu ofron qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në Obiliq dhe Prishtinë.

Për të minimizuar të ekspozuarit e banorëve në operacione minerare, zhvendosja e fshatit do të ngjanë sa më shpejt që të jetë e mundur. Planet e komunitetit dhe të parcelizimit në fshatin Shkabaj kanë

marrë miratimin e komunës së Obiliqit. Tenderët janë kërkuar nga kontraktuesit e kualifikuar të cilët duhet të kryejnë punët infrastrukturore. Pasi që të jetë kompletuar ndarja e parcelave dhe të jetë bartur prona, MMPH do të Te shikohet si do te behet

Qasja në parcelat zëvendësuese në Shkabaj dhe në ndërtimin e shtëpive, nga amvisëritë individuale apo nga MMPH në emër të tyre, do të realizohet menjëherë pasi që të kenë përfunduar punimet bazike infrastrukturore dhe të largimit të dheut (**shih kaptinën 7.8**). Përmes konsultimeve të gjera me komunitetin janë bërë edhe plane për zhvendosje të përkohshme (**shih kaptinën 6.6**) në rast se orari i projektit të KEK-ut apo rreziqet për mbijetesë e bëjnë zhvendosjen të domosdoshme para përfundimit të ndërtimit të shtëpive zëvendësuese.

4.3 Fushëveprimi i zhvendosjes

Për të zhvilluar fazën e parë të planit të mihjes së MEM-it, Projekti do të ngërthejë zhvendosjen e tërë lagjes Shala, e cila përbëhet nga 63 amvisëri rezidente dhe 30 amvisëri jorezidente, pronat e të cilave gjenden në zonën e prekur nga projekti. Do të merren (blihen) të gjitha tokat ndërtimore dhe bujqësore brenda zonës së prekur nga projekti, si dhe shtëpitë, strukturat afariste dhe ndërtesat ndihmëse që gjenden në të.

Zona e mbuluar nga projekti, që mbulon lagjen Shala dhe rrugët, fushat, kullosat dhe tokat e pakultivuara të saj, ka sipërfaqe të gjithmbarshme prej rreth 12.4 hektarësh.

Ndikimet e identifikuar në këtë projekt janë, mes tjerash:

Tabela 4.1: Tabela e ndikimeve

Elementi i prekur	Lloji i ndikimit	Kapitulli/Kaptina
Amvisëritë me pasuri	Zhvendosja fizike 63 amvisëri të përhershme	4.4.1
	Zhvendosja ekonomike 30 amvisëri jo të përhershme që posedojnë prona në zonën e prekur nga projekti	4.4.2
Stabilimentet publike	Zhvendosja ekonomike Rrugët publike	4.5
Mjetet e jetesës	Zhvendosja ekonomike Aktivitetet komerciale Bujqësia si mjet i jetesës Shitja e produkteve nga kopshti Blegtoria	4.6
Qasja publike	Ndikimi social Qasja e rrugëve dhe shtigjeve përmes Shalës	4.7
Komunitetet e afërta (Hade, Shkabaj)	Ndikimet sociale dhe mjedisore Ndikimet nga pluhuri, zhurma dhe pamjet Trafiku Stabilimentet e përbashkëta publike	4.8

4.4 Ndikimet në amvisëri

4.4.1 Amvisëritë e përhershme

Sipas studimit themelor socioekonomik dhe regjistrimit të kryer në vitin 2011, Zona e ndikimit të Projektit banohet nga 320 banorë të përhershëm, që banojnë në 63 shtëpi e të cilët do të zhvendosen fizikisht si rezultat i zhvillimit të projektit.

63 amvisëritë e përhershme në zonën e prekur nga projekti kanë të drejta pronësore mbi strukturën primare të banimit dhe parcelën në të cilën banojnë (tokën ndërtimore). Parcela e vendbanimit zakonisht përshin strukturat e banimit, ndërtesat dhe strukturat ndihmëse jobanesore dhe një hapësirë të vogël kopshti. Disa amvisëri të përhershme kanë gjithashtu të drejta mbi një hapësirë të caktuar të tokave bujqësore.

Sipas regjistrimit asnjë shtëpi apo njësi nuk është nxënë nga ekonomi të ndara familjare.

4.4.2 Amvisëritë e përkohshme

Edhe 30 familje tjera kanë të drejta pronësore mbi struktura dhe/ose parcela që gjenden brenda zonës që do të preket nga projekti, por të cilët vendbanimin primar e kanë në Obiliq, Prishtinë apo jashtë vendit. Këto amvisëri klasifikohen si amvisëri të përkohshme.

Këta pronarë të tokave jobanues do të zhvendosen ekonomikisht si rezultat i zhvillimit të projektit dhe rrjedhimisht kanë të drejtë të kompensohen.

4.5 Ndikimet në stabilimente publike

Stabilimentet publike që gjenden në zonën e prekur nga projekti janë rruga publike në cepin jugor të zonës së vendbanimit. Kjo rrugë është pronë e Komunës së Obiliqit dhe menaxhohet nga ajo.

Shkolla dhe xhamia e shfrytëzuar nga banorët e Shalës gjenden jashtë zonës së prekur nga projekti, në një pjesë tjetër të fshatit Hade. Stabilimentet e shkollimit të mesëm, ato mjekësore dhe të tjera publike që shfrytëzohen nga banorët e Shalës ndodhen në Obiliq apo në qendrat tjera urbane në rajon.

4.6 Ndikimet në mjete të jetesës

Pasi që aktivitetet primar ekonomik në zonën e mbuluar nga projekti është puna me pagesë, ndikimi i zhvendosjes në jetesë është i limituar dhe kryesisht ndërlidhet me aktivitetet bujqësore të nivelit të ulët kryesisht për konsum brenda amvisërive.

Asnjë nga 93 amvisëritë nuk ka deklaruar se e shfrytëzon tokën brenda zonës së mbuluar nga projekti për bujqësi komerciale. 66 amvisëri kanë raportuar se kultivojnë pemë apo perime në tokën e tyre për konsum vetanak. Dhjetë amvisëri kanë raportuar kultivimin e të mbjellave tjera.

Gjashtë amvisëri kanë deklaruar se kultivojnë blegtori. Kullosat gjenden në tokat bujqësore në cepin verior të zonës së prekur nga projekti si dhe në tokat e ngjitura me atë zonë.

Në zonën e prekur nga projekti ekziston një ndërmarrje afariste, një klub bilardoje që shet çaj dhe pije tjera.

4.7 Ndikimi në qasje publike

Siç u cek më lartë, zhvillimi i projektit do të ketë ndikim në rrugën publike përmes lagjes Shala. Për shkak të zhvillimeve të fundit në minierë, rruga primare nuk vazhdon më në perëndim të Shalës për tu lidhur me komunitetet e afërta. Qasja në rrugë në perëndim dhe jug është e qasshme për publikun por kontrollohet në pikat kryesore të kyçje nga KEK-u për të menaxhuar ndikimin e operacioneve minerare dhe trafikut të ndërlidhur me to. Kjo do të ndodh edhe gjatë eksploatimit të Fushës së Re të Mihjes.

4.8 Ndikimet në komunitetet e afërta

Operacionet minerare dhe aktivitetet e zhvendosjes do të ndikojnë jo vetëm në lagjen Shala por edhe në amvisëritë tjera në Hade dhe Shkabaj.

Realiteti operativ në mihje sipërfaqësore dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të saj do të vazhdojnë të kenë ndikim në amvisëritë tjera në Hade. Infrastruktura mund të pësojë nga trafiku dhe potencialisht nga marrja e mëtejme e tokave. Prospekti i një zhvendosjeje në të ardhmen do të ketë ndikim social në amvisëritë e Hades, ngase ata do të jenë në pritje të realizimit të planeve të propozuara. Ndalimi i ndërtimit, për shkak të shpalljes si zonë e interesit nacional në vitin 2004, mund të ndikojë në kapacitetin e amvisërive për tu rritur dhe për të akomoduar qiftet e sapomartuara dhe fëmijët e porsalindur.

Zhvendosja gjithashtu do të ketë ndikim të veçantë në fshatin ekzistues Shkabaj jo nuk kemi folurposaçërisht kur kemi parasysh afërsinë e tij me lokacionin ku do të bëhet zhvendosja. Gjatë fazës së parë të ndërtimit në këtë lokacion, qasja rrugore përmes fshatit Shkabaj drejt zonave urbane do të jetë e limituar. Disa lidhje në infrastrukturë publike do të realizohen përmes rrjeteve ekzistuese në Shkabaj. Amvisëritë e zhvendosura ka gjasa që fëmijët e tyre të moshës përkatëse për shkollim fillor t'i dërgojnë fëmijët në shkolla të zonës, sepse Shkabaj për momentin nuk ka shkollë të tillë dhe është pjesë e komunës së Obiliqit.

Përfundimisht, zhvillimi i lokacionit ku do të kryhet zhvendosja do të t'i ofrojë fshatit Shkabaj disa stabilimente të reja dhe do t'ia lehtësojë qasjen në to, si dhe do t'ia ofrojë një dalje të dytë në autostradë.

5. ANGAZHIMI I PALËVE ME INTERES

5.1 Udhëzimet e IFC-së

Udhëzimet e IFC-së thonë se “Planifikimi efektiv i zhvendosjes kërkon konsultime të rregullta me një sërë palësh me interes për projektin. Konsultimet e hershme ndihmojnë në menaxhimin e pritjeve të publikut lidhur me ndikimet e projektit dhe përfitimet nga ai. Konsultimet e mëtejme i ofrojnë propozuesve të projektit dhe përfaqësuesve të popullatës së prekur mundësi të negocimit të pakove të kompensimit dhe kushteve të kualifikimit, asistencës në zhvendosje dhe përcaktimit të orarit të aktiviteteve të zhvendosjes”.

5.2 Synimet

KEK dhe MMPH kanë zhvilluar konsultime të shpeshta publike me qëllim të paraqitjes së aktiviteteve që nga fillimi i planifikimit të projektit në vitin 2004, në formate të ndryshme dhe me grupe të ndryshme të palëve me interes. Këto përpjekje për të angazhuar palët me interes kishin për qëllim:

- Të ofrojnë rrjedhë të vazhdueshme të informatave lidhur me projektin për amvisëritë e prekura, përfshirë progresin në planifikimin, ndërtimin dhe aktivitetet tjera me qëllim të marrjes së informatave kthyesë nga ta;
- Të sigurojnë se palët me interes do të kontribuojnë në identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve potenciale;
- Të sigurojnë se palët me interes do të kontribuojnë në planifikimin e planit të zhvendosjes, i cili duhet të jetë i kujdesshëm ndaj ndikimeve të projektit, të ofrojë përfitime për personat e prekur dhe të kualifikuar dhe të pasqyrojë mënyrat e jetesës, zgjidhjet e bëra dhe aspiratat e komunitetit të prekur nga projekti;
- Të përcaktojnë një mekanizëm formal për adresim të pakënaqësive, për të mundësuar paraqitjen e ankesave dhe për të siguruar zgjidhjen e tyre në kohën më të shkurtër të mundshme; dhe
- Të identifikojnë dhe zgjidhin të gjitha problemet sa më shpejtë që të jetë e mundur përmes dialogut dhe angazhimit të përbashkët.

Synim i konsultimeve, zbulimit të informatave dhe angazhimit në fazat aktuale dhe të ardhshme të projektit është që të kërkojë përkrahje nga komuniteti i gjerë dhe të merr parasysh parimet e një konsultimi të lirë (të lirë nga kërcënimet apo cytja), paraparak (me zbulim të informatave me kohë) dhe të informuar (duke ofruar informata relevante, të kuptueshme dhe të qasshme).

Kjo qasje dhe parimet e respektimit të komuniteteve lokale, transparencës, drejtësisë dhe konsistencës në komunikim me palët me interes, do ta udhëheqin procesin e sajimit dhe implementimit të aktiviteteve të angazhimit të publikut që ndërlidhen me këtë PVZH.

5.3 Identifikimi i palëve me interes

Palë me interes në zhvendosje janë individët, grupet dhe organizatat që kanë interes legjitim në procesin e zhvendosjes, përfshirë posaçërisht popullatën, amvisëritë dhe komunitetet e prekura nga projekti, autoritetet politike relevante, agjencitë përkatëse qeveritare dhe organizatat e interesuara të shoqërisë civile. **Tabela 5.1** liston palët e identifikuar me interes.

Tabela 5.1: Palët me interes në zhvendosje

Grupi i palëve me interes	Palët individuale me interes
Propozuesit e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Korporata energjetike e Kosovës • Programi i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti • Punëtorët • Kontraktorët
Zona e ndikimit të Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëtarët e komunitetit <ul style="list-style-type: none"> • Pronarët me banim të përhershëm • Pronarët me banim të përkohshëm • Qiramarrësit • Pronarët e tokave • Pronarët dhe punëtorët e bizneseve
Komunitetet e afërta	<ul style="list-style-type: none"> • Shkabaj • Hade • Komunitetet tjera në komunën e Obiliqit
Qeveria dhe autoritetet lokale	<ul style="list-style-type: none"> • Lokale <ul style="list-style-type: none"> • Komunën e Obiliqit • Autoritetet arsimore • Kombëtare <ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor • Ministria e Zhvillimit Ekonomik • Ministria e Financave • Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

5.4 Metodologjia

Angazhimi mes KEK-ut, MMPH-së dhe palëve me interes në zhvendosje bëhet në forume dhe formate të ndryshme, përfshirë:

- Takimet formale me pjesëtarë dhe përfaqësues të komunitetit të prekur të Shalës;
- Takimet sy-më-sy;
- Negociatat individuale për blerjen e tokës dhe kompensimin; dhe
- Aktivitetet tjera për angazhimin e palëve me interes.

5.4.1 Takimet formale

Takimet formale të mbajtura deri tani

KEK dhe MMPH kanë organizuar një seri të takimeve formale me palët me interes lidhur me procesin e planifikimit të zhvendosjes.

Si pjesë e agjendës më të gjerë lidhur me zonën e projektit, Zyra e Projektit të Hades në MMPH i ka paraqitur informatat dhe u është përgjigjur pyetjeve lidhur me progresin në planifikimin e zhvendosjes, kualifikimin për kompensim dhe negociatat individuale për marrje të tokës, procedurat e zhvendosjes dhe oraret të projektit. Këto azhurnime janë kyçe për konsultimet që Projekti zhvillon me palët me interes në Shalë.

Në përgjithësi, këto takime kanë shërbyer për të:

- Ofruar informata lidhur me projektin për personat e prekur nga projekti dhe palët tjera me interes;

- Ofruar informata lidhur me procesin e planifikimit të zhvendosjes, përfshirë praktikat më të mira ndërkombëtare dhe zotimet e Kompanisë për të qenë në pajtueshmëri me to;
- Ofruar azhurnime lidhur me vendimet kyçe të marra në procesin e planifikimit të zhvendosjes; dhe
- Për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe brengave të paraqitura.

Takime formale janë organizuar edhe me përfaqësuesit e komunitetit të Shalës edhe me komunitetin në tërësi (në formë të takimeve të hapura). Takimet me komunitetin janë zhvilluar në vitin 2004 me qëllim të identifikimit të lokacionit të preferuar për zhvendosje dhe në vitin 2006 me qëllim të integritit të mendimeve të marra nga amvisëritë e prekura nga projekti gjatë përgatitjes së Planit Rregullativ Urban për lokacionin e zhvendosjes (**shih kaptinën 7.2**).

Në vjeshtë të vitit 2010 (në vitin 2009 janë parqitur keto kërkesa), përfaqësuesit e komunitetit të Shalës paraqitën çështjet me rëndësi për diskutim dhe marrëveshje, para se të kryhet hulumtimi bazik. Konsultimet mes KEK-ut, MMPH-së dhe përfaqësuesve të Shalës rezultuan me përfshirjen e katër amvisërive shtesë, të cilat konsiderohen pjesë e komunitetit të Shalës, në procesin e zhvendosjes dhe me mundësimin e punësimit të njëzet pjesëtarëve të amvisërive të Shalës në KEK.

Në fillim të vitit 2011 u organizuan një sërë takimesh kyçe për të diskutuar lidhur me aktivitetet e hulumtimit dhe procesin e planifikimit të zhvendosjes. Një seri prej 4 takimeve të hapura, janë mbajtur në shkollën e mesme të Hades (me 28 Qershor, 01 Korrik, 06 Korrik dhe 20 Korrik) duke përmbledhur procesin e planifikimit të zhvendosjes dhe duke ftuar palët e interesuara që të ofrojnë idetë e tyre lidhur me një sërë çështjesh të caktuara përmes një agjende formale, si: paket e kompensimit, kualifikimet për kompensim, procedura të zhvendosjes, dizajnin e komunitetit pas zhvendosjes dhe shtëpive ku do të kryhet zhvendosja (**shih kaptinën 7.2**), mundësitë për zhvendosje të perkohshme dhe të tjera. Një përmbledhje e draft Planit të Veprimit të Zhvendosjes është prezentuar në një takim të hapur me 5 Gusht, 2011. Hapat tjerë, duke përfshirë këtu planin për takimet tjera të ardhshme formale të përshkruara më poshtë, ishin gjithashtu pjesë e diskutimit.

Zyra e Projektit të Hades mban regjistrat dhe procesverbalet e të gjitha takimeve formale.

Takimet formale në të ardhmen

Takimet e hapura gjithashtu do të organizohen për të adresuar çështje të caktuara që ndërlidhen me planifikim, përgjate periudhës së përfundimit të draft PVZH-së, si dhe para finalizimit të PVZH-së dhe marrëveshjeve individuale.

Janë paraparë edhe grupe specifike të fokusit me gra dhe fëmijë për të siguruar pjesëmarrje të plotë dhe adekuate dhe për të marrë idetë e grupeve të caktuara brenda komunitetit të prekur nga projekti.

Pas finalizimit të PVZH-së dhe nënshkrimit të marrëveshjeve individuale, KEK dhe MMPH do të vazhdojnë të konsultohen me palët me interes në lagjen e Shalës. Takime të rregullta me komunitetin do të mbahen (së paku) në baza mujore për gjashtë muajt e parë dhe një herë në dy muaj për 18 muaj me radhë pas zhvendosjes.

Takimet e komunitetit do të mbahen paraprakisht para qasjes në tokën zëvendësuese që do t'i jepet amvisërive të kualifikuara (p.sh. për të shqyrtuar tiparet e tokës dhe shërbimet e ofruara, dhe procedurat dhe orarin e ndërtimit).

5.4.2 Takimet sy-më-sy

Përveç takimeve formale të përshkruara më lartë, punonjës të MMPH-së dhe KEK-ut, veçanërisht stafi i Zyrës së Projektit të Hades, do të angazhohen në diskutime ditore me komunitetet e prekura dhe do të konsultohen për një sërë çështjesh me lidhshëm lokal politik (d.m.th. me komunën e Obiliqit), me personat e prekur nga projekti dhe opinionin publik. Këto aktivitete zakonisht organizohen në formë të takimeve sy-më-sy, qoftë në terren qoftë në Zyrën e Projektit të Hades. Kontraktorët dhe konsulentët e angazhuar në projekt gjithashtu ndërveprojnë me popullatën e prekur, edhe gjatë aktiviteteve të ndërlidhura me realizimin e hulumtimit bazik.

Ky dialog i vazhdueshëm ka mundësuar këmbim të hapur të informatave dhe shtim të ndjenjës së besimit tek stafi i MMPH-së dhe KEK-ut, në procesin e planifikimit të zhvendosjes dhe në zotimet e bëra.

5.4.3 Negociatat individuale

Paralelisht me zbulimin e Draft PVZH-së në gusht 2011, MMPH filloj takimet me amvisëritë e prekura nga projekti, për të rishikuar edhe një herë të dhënat në lidhje me pasuritë, kualifikimet dhe opsionet e tyre për zhvendosje. Amvisëritë kanë patur pesë ditë për t'i raportuar pasaktësitë apo pyetjet që mund t'i kenë patur.

Amvisëritë do të kenë në dispozicion kopje të të dhënave dhe do të kenë pesë ditë për t'i raportuar

Këto diskutime paraqesin bazën për negociatat individuale me amvisëritë e kualifikuara sa i përket marrëveshjeve të kompensimit. Negociatat individuale janë udhëhequr nga punonjësit e MMPH-së, me përkrahje nga KEK-u dhe konsulenti për zhvendosje – rePlan. Negociatat janë bazuar në dialog të përshkruar me respekt dhe informata adekuate. Caktimi i takimeve varet nga vlerësimi i amvisërive të prekura.

Marrëveshjet do të vërtetohen me shkrim në dokumente përmes të cilave arrihet marrëveshja për bartjen e pronës (për vlerat e prekura në Hade) tek Qeveria, me kusht të pagimit të plotë të kompensimit dhe bartjes së pronësisë mbi tokën zëvendësuese në fshatin tjetër (nëse janë të kualifikueshëm).

6. KORNIZA PËR KOMPENSIME

6.1 Udhëzimet e IFC-së

Korniza e Kompensimit e PVZH, sipas IFC-së, duhet t'i specifikojë "të gjitha format e të drejtave të pronësisë apo të drejtave të shfrytëzimit të aseteve tek popullata e prekur nga projekti dhe strategjia e projektit për kompensimin e tyre për humbje të pjeshme apo të plotë të atyre aseteve."

Veç kësaj, IFC rekomandon që sponsoruesi i projektit t'i ndërmarr hapat në vijim në emër të Popullatës së Prekur nga Projekti:

"T'i informojë njerëzit e prekur lidhur me alternativat e tyre dhe të drejtat në lidhje me zhvendosjen; të ofrojnë opsione teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme për zhvendosje, bazuar në konsultimet me popullatën e prekur; të ofrojnë asistencë në shpenzimet e zhvendosjes, mbështetje kalimtare financiare; si dhe të t'iu sigurojnë personave të prekur asistencë zhvillimore".

6.2 Objektivat

Planifikimi i kornizës së kompensimit është drejtuar nga objektivat vijues:

- Rivendosja dhe përmirësimi i jetesës dhe mirëqenies së personave dhe ekonomive familjare të zhvendosur fizikisht apo ekonomikisht ashtu që ato të jenë të njëjta apo më të mira sesa para zhvendosjes;
- Ofrimi i kompensimit të drejtë dhe në kohë që është i barabartë apo tejkalon shpenzimet e zëvendësimit të aseteve dhe aktiviteteve të prekura dhe që përfshin banim dhe infrastrukturë të cilësisë së barabartë apo më të mirë;
- Krijimi i politikave, procedurave, niveleve të kompensimit dhe proceseve të masave për zbutje që janë të pranueshme nga të gjitha palët dhe të drejta, përmes konsultimit me popullatën e prekur nga projekti dhe përfaqësuesit e tyre;
- Trajtimi i ndikimeve të projektit dhe mirëqenies së popullatës së prekur në mënyrë gjithëpërfshirëse – në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë;
- Shpërblimi i vetëbesimit, inkurajimi i vetë-ndihmës dhe respektimit, si dhe të shfrytëzohen përparësitë socio-ekonomike dhe kulturore të zonës; dhe
- Zbatimi i një procesi të klasit të lartë të zhvendosjes në pajtim me ligjet e Kosovës dhe praktikat më të mira ndërkombëtare që do të shërbejnë si shembull për proceset e ardhshme të zhvendosjes në Kosovë.

6.3 Baza ligjore

Korniza e Politikave të Zhvendosjes e Republikës së Kosovës për Fushën e Re të Mihjes, e miratuar nga Qeveria e Kosovës në korrik 2011, përcakton procedurat dhe politikat e kompensimit që duhet ndjekur nga zbatuesit e projektit që kërkojnë të sigurojnë tokë në Fushën e Re të Mihjes.

Planet e Veprimit për Zhvendosje do të përgatiten për çdo komponentë të projektit në pajtim me KPZH, OP 4.12 të Bankës Botërore, si dhe Standardin e Performancës së IFC-së 5. KPZH identifikon kriteret

për kualifikim dhe opsionet e të drejtave që do t'i prezantohen personave të prekur nga projekti në një proces transparent, pjesëmarrës të planifikimit.

Ligji për Miniera dhe Minerale (03/L-081), i miratuar në qershor 2008, përcakton që kompanitë e mihjeve mund të negociojnë me pronarët e tokave lidhur me blerjen e të drejtave sipërfaqësore. Ligji lejon arritjen e marrëveshjeve miqësore dhe vullnetare të blerjes së tokës ndërmjet Kompanisë dhe pronarit të tokës.

Nëse Kompania dhe pronari i tokës nuk arrijnë të lidhin marrëveshje, Kompania mund të iniciojë procedurat e shpronësimit qeveritar. Pas përmbylljes së procedurave për shpronësim, pronari i tokës do të ketë të drejtë në kompensim të drejtë në nivel të përcaktuar nga Gjykata nëse nuk pranon normat nën nivelin e përcaktuar për transferimin e tokës dhe/apo titullin e shtëpisë.

6.4 Kualifikimi

Personat e prekur nga projekti kanë të drejtë në kompensim dhe ndihma të tjera nëse kanë “interes legjitim” në asete të paluajtshme apo aktivitete të jetesës në Zonën e ndikimit të Projektit që kanë qenë të zhvilluara – d.m.th. të mbjella apo të ndërtuara – në kohën e regjistrimit me 2011 dhe anketave për asetet në pajtueshmëri me Kornizën Politike të Zhvendosjes. (Në praktikë, data e ndërprerjes së të drejtës e aplikuar për ekonomi familjare të prekur nga projekti është data në maj apo qershor 2011 në të cilën ekipet hulumtuese kanë menaxhuar regjistrimin e popullsisë, anketimin dhe inventarin e aseteve për atë ekonomi familjare.)

Interesi legjitim në asete të paluajtshme në nivel të ekonomisë familjare zakonisht mbahet nga një anëtar i vetëm: kryefamiljari. Në disa raste interesi legjitim mund të jetë i përbashkët: d.m.th. i kryefamiljarit dhe bashkëshortit të tij/saj, apo edhe i anëtarëve të tjerë të familjes së gjerë.

Asetet e paluajtshme përfshijnë:

- Tokën – tokën e kultivuar, kullosat dhe parcelat e banimit;
- Strukturat – strukturat e banimit të ekonomive familjare (për jetesë, fjetje, gatim, deponim të gjërave personale) dhe strukturat jobanesore (ahuret/kotecet, muret e gurit/rrethojat, garazhet dhe anekset), si dhe ndërtesat ekonomike;
- Të korrurat – ushqimi, paraja e gatshme dhe të frutat e pemëve; dhe
- Rrugët – të gjitha rrugët e pranuar nga qeveria.

Kriteret tjera specifike të së drejtës së kualifikuar janë përkufizuar në **Pjesën 6.5** dhe **Tabelën 6.1** më poshtë.

6.5 Të drejtat

6.5.1 Pasqyrë

Përmes konsultimeve me ekonomitë familjare të prekura nga projekti dhe hisedarët e tjerë të projektit, MMPH-ja ka definuar një shkallë të të drejtave në kompensim të drejtë dhe adekuat për ndikimet e kualifikuara. Kjo pjesë përvijon të drejtat në kompensim në dispozicion për humbje të tokës, humbje të strukturave, humbje të të korrurave dhe humbje të veprimtarisë afariste. Këto të drejta janë përmbledhur në **Tabelën 6.1**.

Të drejtat e përvijuara në **Tabelën 6.1** dhe pjesët pasuese të këtij kapitulli paraqesin politikën aktuale të aplikuar nga MMPH-ja dhe KEK-u në negociatat për kompensim me ekonomi familjare individuale.

Për sa i përket kompensimit në para të gatshme, të gjithë nivelet e kompensimit, kalkulimet e kompensimit dhe pagesat e kompensimit bëhen në valutën ligjore të Kosovës, në Euro.

Tabela 6.1: Matrica e të drejtave

Aseti i prekur	Palët me të drejta	Kualifikimi	Kompensimi	Kapitulli Pjesa
TOKA				
Toka bujqësore	Pronar i ligjshëm apo pronari i regjistruar me titull të plotë ligjor Banues	Pronari i ligjshëm ose i regjistruar i asetit deri në datën e ndërprerjes së të drejtës Banues i pranuar i identifikuar në anketimet e asetëve apo socio-ekonomike dhe/apo nga MMPH	Kompensim në para të gatshme në nivel të zëvendësimit Kompensim i barabartë me dy vite të fitimeve neto në bazë të tokës	6.5.3
Toka urbane	Pronar i ligjshëm ose i regjistruar me titull të plotë ligjor	Pronari i ligjshëm ose i regjistruar i asetit deri në datën e ndërprerjes së të drejtës	Zëvendësim standard i parcelës në një fshat të ri. Nëse parcela e zëvendësuar është me e vogël sesa ajo ekzistuese, ndryshimi në vlerë pranohet në para të gatshme APO Kompensim në para të gatshme në nivel të vlerës zëvendësuese	6.5.4
Tokë publike	Pronar i regjistruar (qeveria komunale, Qeveria e Kosovës)	Pronar i regjistruar i asetit deri në datën e ndërprerjes së të drejtës	Zëvendësim me toka të ngjashme në fshatin e zhvendosjes APO Blerje në para të gatshme	6.5.5
STRUKTURAT				
Strukturat e banimit	Pronar i pranuar i	Pronar i pranuar i asetit deri në datën	Zëvendësim standard i shtëpisë në fshatin e ri. Nëse shtëpia e	6.5.6

Aseti i prekur	Palët me të drejta	Kualifikimi	Kompensimi	Kapitulli Pjesa
	strukturës së banimit në tokë ndërtimore Pronar i pranuar i strukturës së banimit në tokë bujqësore	e ndërprerjes së të drejtës Pronar i pranuar i asetit deri në datën e ndërprerjes së të drejtës	zëvendësuar është me e vogël sesa ajo ekzistuese, pranohet ndryshimi në vlerë. APO Kompensim në para të gatshme në nivel të zëvendësimit Kompensim në para të gatshme në nivel të zëvendësimit	
Rrethoja, mure guri, dhe anekse	Pronar i pranuar	Pronar i pranuar i asetit deri në ditën datën e ndërprerjes së të drejtës	Kompensim në para të gatshme në nivel të zëvendësimit	6.5.7
Struktura komerciale	Pronar i pranuar	Pronar i pranuar i asetit deri në ditën datën e ndërprerjes së të drejtës	Kompensim në para të gatshme në nivel të zëvendësimit	6.5.8
MJETET E JETESËS				
Mjete tokësore të jetesës	Individ apo ekonomi familjare ekonomikisht e zhvendosur	Aktiviteti i jetesës mbështetet në asetet e paluajtshme të prekura apo në qasjen në Zonën e ndikimit të Projektit	Pjesëmarrja në rikthimin e mjeteve të jetesës dhe programet e asistencës, të përshkruar në Kapitullin 8	8
Veprimtaria afariste	Pronar i biznesit	Pronarë të biznesit të regjistruar në anketim në kohë para datës së ndërprerjes së të drejtës, pavarësisht zotërimit të tokës	Kompensim në para të gatshme ekuivalent me të hyra neto për gjashtë muaj APO Kompensim në para të gatshme ekuivalent me të hyra neto për 12 muaj nëse përfituesi rihap biznes në komunën e prekur Kompensim në para të gatshme ekuivalent me të hyra neto gjatë periudhës së tranzicionit	6.5.9
Punësimi	Punonjësit	Punonjës me orar të plotë dhe me gjysmë orari	Kompensim në para të gatshme ekuivalent me paga për gjashtë muaj DHE Pjesëmarrje në rikthimin e mjeteve	6.5.9

Aseti i prekur	Palët me të drejta	Kualifikimi	Kompensimi	Kapitulli Pjesa
			të jetesës dhe programet e asistencës	
TË KORRURAT				
Pemë dhe të korrura	Vetë mbjellësi dhe/apo pronari i të korrurave	Vetë mbjellësi dhe/apo pronari i të korrurave (i regjistruar në anketim në kohë të ndërprerjes së datës së të drejtës), pavarësisht zotërimit të tokës	Kompensim në para të gatshme në nivel të dakorduar të zëvendësimit	6.5.10
QAJA PUBLIKE				
Qasja në rrugë	Përdorues të rregullt		Mirëmbajtje e rrugës së devijuar	6.5.11
ASISTENCA DHE LEJIME TJERA				
Shpenzimet e rivendosjes	Pronar apo qiramarrës i regjistruar	Ekonomi familjare të zhvendosura nga strukturat e banimit	Shumë paushall për të mbuluar shpenzimet e mobilizimit/ rivendosjes në lokacion të fshatit të ri DHE Ofrimi i një ngarkese me kamion për bartjen e gjërave personale	6.5.12
Materialet strukturore	Pronar i pranuar	Pronar i pranuar i një strukture para zhvendosjes	E drejta për ta riaftësuar para zhvendosjes	6.5.12
Korrje-shirjet	Vetë mbjellësi / pronari i të mbjellave	Vetë mbjellësi / pronari i të mbjellave, pavarësisht zotërimit të tokës	E drejta në korrje-shirje para zhvendosjes	6.5.12

Pagesat për ekonomitë familjare të prekura do të bëhen në dy hapa: 30% në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare dhe 70% pas bartjes së titullit (do të definohet gjatë degjimit publik sakte, KEK deklarohet se do ta bëjë 100 % në një keq pagesën).

6.5.2 Procesi i planifikimit të të drejtave

Procesi i planifikimit të të drejtave ngërthen tri detyra primare:

- Përcaktimi i normave të kompensimit në para të gatshme për kompensim për ndikime specifike për ekonomitë familjare të kualifikuara, duke përfshirë norma të kompensimit për tokë, struktura dhe të korrura;
- Planifikimi dhe sajimi i aseteve zëvendësuese për kompensim për ndikime specifike të ekonomive familjare të kualifikuara, duke përfshirë shtëpitë dhe parcelat e banimit (shih **Kapitullin 7**);
- Sajimi i nismave plotësuese të kompensimit për t'i zbutur edhe më tej rreziqet e zhvendosjes, duke përfshirë asistencën në rivendosje, nismat për rikthimin e mjeteve të jetesës (shih **Kapitullin 8**), masat për ndihmë ndaj personave të cenueshëm (shih **Kapitullin 9**).

Normat e kompensimit në para të gatshme për asete të ndryshme të ndikuara që janë përshkruar në këtë kapitull janë menduar që personave të prekur të iu ofrojnë kompensim të barabartë apo më të lartë sesa vlera e zëvendësimit, pa zbritje të zhvlerësimit.

Tre koeficientët të ndryshëm janë aplikuar në vlerën e zëvendësimit të një aseti të ndërtuar në varësi të nivelit dhe cilësisë së ndërtimit. Këto norma bazë, dhe metodologjia e përcaktimit të vlerës në përgjithësi (**shih Shtojcën A**), janë hartuar në vitin 2004 nga një grup punues i përbërë nga zyrtarë të Qeverisë nga MMPH, MEF, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, KEK-ut dhe Komunës së Obiliqit. Kriteret e vlerësimit janë marrë nga proceset e mëparshme të kompensimit dhe ndërtimit, si dhe shpenzimet e pasurive të patundshme. Kriteret janë shqyrtuar në detaje me banorët e lagjës Shala dhe janë miratuar nga Qeveria më 3 nëntor 2004 (Vendimi nr 5 / 119). Normat janë vlerësuar si më shumë se të mjaftueshme për ndërtimin ose zëvendësimin e aseteve, sipas vlerësimit të palës së tretë për shpenzimet e zëvendësimit.

Premiumi prej 10% do të zbatohet për të gjitha vlerësimet, në njohje të ndikimit të zhvendosjes dhe bashkëpunimit me familjet e prekura.

Që nga mesi i vitit 2011, MMPH ka konsultuar ekonomitë familjare të prekura nga projekti për t'i paraqitur, shqyrtuar dhe debatuar normat dhe përfitimet e propozuara dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre duke pasur parasysh ndikimet e zhvendosjes. MMPH inkorporoj inputet e tyre në dizajnet përfundimtare të projektit në mënyrë që të standardizoj dhe finalizoj kornizën kompensimit.

Pakot specifike të kompensimit për ekonomitë familjare janë shqyrtuar me secilën ekonomi familjare të kualifikuar, duke filluar në gusht 2011.

6.5.3 Humbja e tokës bujqësore

Tokat bujqësore në Zonën e Ndikimit të Projektit janë në zotërim privat të individëve dhe ekonomive familjare.

Tokët rurale në Shalë janë destinuar si toka bujqësore dhe janë kategorizuar sipas tetë kategorive të vlerës bazuar në pjellorinë e tokës (I deri VIII). Ky kategorizim është shfrytëzuar në përcaktimin e vlerës për tokat e prekura, si dhe vlerës së zëvendësimit të tokës rurale, nëse aplikohet.

Pronarët e regjistruar dhe të pranuar të tokave të prekura rurale në Zonën e Ndikimit të Projektit kanë të drejtë në kompensim me para të gatshme, ekuivalent me vlerën e zëvendësimit të pronave të tyre të prekura, duke shfrytëzuar normat e kompensimit të parashtruara në **Shtojcën A**.

Pronarët e pronave të prekura të cilët mund të dëshmojnë varësi ekonomike ose jetese, mund të kualifikohen për të marrë tokë të rehabilituar (në zonat e djerrinës që janë në pronësi të KEK-ut aktualisht) ekuivalente me vlerën zëvendësuese të tokave të tyre të prekura në vend të parave të gatshme.

Pronarët e tokave të caktuar si bujqësore nuk kanë të drejtë në parcela zëvendësuese në fshatin e zhvendosjes.

Qiramarrësit e tokave bujqësore deri në kohën e anketës së 2011 kanë të drejtë në kompensim ekuivalent deri në dy vite të fitimeve neto nga ajo tokë.

Nëse pronarët dhe qiramarrësit janë përfshirë në mjete produktive të jetesës të bazuar në tokë, në Shalë ekzistenca është kryesisht nga bujqësia, KEK-u gjithashtu zotohet që këtyre ekonomive familjare

të ju ofrojë qasje në toka dhe resurse alternative të mjaftueshme që ata t'i rikthejnë apo përmirësojnë aktivitetet e jetesës.

Të gjitha ekonomitë familjare të prekura janë të kualifikuara që të marrin pjesë në Programin për Rikthimin e Mjeteve të Jetesës dhe Zhvillimin e Komuniteteve, i cili është në zhvillim e sipër (shih **Kapitullin 8**).

6.5.4 Humbja e tokës urbane

Tokat urbane në Zonën e ndikuar të Projektit përbëhen nga parcela private të banimit të destinuar si tokë ndërtimore.

Pronarët e tokave ndërtimore të shënuar në regjistrat kadastrorë kanë të drejtë në njërin opion të pranimit:

1. Titull pronësor pa kufizime në parcelë zëvendësuese të banimit në fshatin e zhvendosur në Shkabaj; apo
2. Kompensim në para të gatshme në nivel ekuivalent me vlerën e zëvendësimit të parcelës së prekur (shih **Shtojcën A**).

Ekonomive familjare do t'u ofrohet përzgjedhja e madhësive të parcelave zëvendësuese – 300-450, 450-550 apo 550-700 m² (nëse parcela që zotërojnë në Shala është më e vogël se 300 m², por janë të interesuar për parcelë më të madhe, atëherë diferenca kryhet nga vlera tjetër e pasurisë). Variacionet në madhësi të parcelave rezultojnë për shkak të topografisë së terrenit dhe kufizimeve në projektim. Nëse parcela e identifikuar është më e vogël sesa parcela ekzistuese e ekonomisë familjare në Shalë, ekonomisë familjare do t'i sigurohet kompensim në para të gatshme në vlerë të barabartë me ndryshimin e hapësirës (duke përdorur normat e kompensimit të përkufizuara në **Shtojcën A**).

Parcelat zëvendësuese janë mjaft të mëdha sa që mbulojnë hapësirën për shtëpinë e zëvendësuar si dhe një varg aktivitetesh lidhur me shfrytëzimin e tokës (p.sh. kopshtari komerciale, punëtori).

Për tokat që përfshijnë ndërtimin në afërsi me tokat bujqësore brenda një bartësi të parcelës, tokat bujqësore mund të riklasifikohen si tokë ndërtimore me qëllim kompensimi, deri në gjithsej 500 m² tokë ndërtimore për nënndarje të parcelës.

6.5.5 Humbja e tokës publike

Tokat publike në Zonën e ndikimit të Projektit janë të kufizuara në të drejtat e kalimit në rrugë publike. Këto toka janë në zotërim të autoriteteve komunale të Obiliqit.

KEK-u kompenson humbjen e këtyre tokave duke ofruar tokë në formë të zëvendësimit në natyrë në fshatin e ri për t'i akomoduar stabilimentet zëvendësuese dhe ato të reja (shih **Kapitullin 7**). Titulli i të drejtës së re publike të kalimit do t'i bartet autoriteteve komunale pasi që infrastruktura dhe punët tjera bazike të kenë përfunduar në fshatin e zhvendosur.

Projektimet për fshatin e zhvendosur do të sigurojnë qasje më të madhe ku të gjitha pronat e banimit do të përfitojnë nga rrugët anësore të lidhura me rrugët kryesore.

6.5.6 Humbja e strukturave të banimit

KEK-u do të kompensojë humbjen e strukturave të banimit që ishin të pranishme, te regjistruara në kohën e anketës së vitit 2011.

Pronarët e ligjshëm që zotërojnë struktura të banimit të ndërtuara me leje të ndërtimit në toka ndërtimore kanë të drejtë në njërin opsion të pranimit:

1. Shtëpi zëvendësuese në parcelën e banimit të ekonomisë familjare në fshatin e zhvendosur që do të sigurohet nga KEK-u; apo
2. Kompensim në para të gatshme ekuivalent me vlerën zëvendësuese të strukturës së prekur të banimit (sipas normave të kompensimit të përkufizuara në **Shtojcën A**).

Të gjitha ekonomitë e kualifikuara familjare do të kenë të drejtë të pranojnë shtëpi standarde të ndërtuar në përputhje me standardet kombëtare të ndërtimit, madhësinë e familjes dhe nevojat saj. Pronarët që kanë shtëpi më të mëdha sesa madhësia standarde do të pranojnë pagesë në para të gatshme të barabartë me vlerën zëvendësuese të ndryshimit në hapësirë (sipas normave të kompensimit të përkufizuara në **Shtojcën A**).

Shtëpitë zëvendësuese do t'i përmbushin detyrimet dhe standardet ligjore të Kosovës dhe projektohen në mënyrë të pranueshme në aspekt kulturor në mënyrë që të plotësohen nevojat e ekonomive familjare dhe stilet e jetës së personave të prekur.

Pronarët e shtëpive që pranojnë parcelë të banimit në fshatin e zhvendosur në Shkabaj mund të zgjedhin që të pranojnë kompensim në para të gatshme në për humbjen e strukturave të tyre të banimit dhe ndërtimin ta bëjnë vetë. Këto ekonomi familjare duhet t'i dorëzojnë aplikacionet për leje të ndërtimit sipas modeleve të shtëpive zëvendësuese të zhvilluar në konsultimet publike të Projektit (shih **Pjesën 7.5**). Madhësia standarde dhe dizajni janë dakorduar gjatë konsultimeve ndërmjet MMPH-së, KEK-ut dhe personave të prekur nga projekti.

Pronarët e ligjshëm të strukturave rezidenciale të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe / ose në tokë bujqësore do të marrin kompensim ekuivalent në të holla për vlerën e zëvendësimit të strukturës së prekur, duke përdorur normat e kompensimit të përcaktuar në **Shtojcën A**.

Pronarët që pranojnë kompensim në para të gatshme për strukturat e tyre të banimit, por që kanë zgjedhur të mos zhvendosen në lokacionin Shkabaj, duhet të jenë në gjendje që t'i demonstrojnë Zyrës së Projektit në Hade se ata tanimë kanë qasje në një vend të ri të banimit apo se kanë identifikuar një shtëpi të re (p.sh. se kanë lidhur marrëveshje për shitblerje) në të cilën do të mund të vendosen para apo gjatë kohës së rivendosjes. Gjithashtu, MMPH do të realizojë një program specifik të monitorimit për të siguruar se ekonomitë familjare që vendosen jashtë fshatit të zhvendosur kanë realizuar qasje në banim adekuate me titull përkatës (dhe vazhdojnë ta kenë), kanë ruajtur qasjen në mjete të qëndrueshme të jetesës dhe se nuk kanë përjetuar nivele të larta të çrregullimit social, familjar dhe të komunitetit si pasojë e zhvendosjes.

6.5.7 Humbja e strukturave tjera

Pronarët e regjistruar dhe të pranuar të strukturave të paluajtshme shtesë, duke përfshirë ahuret dhe kotecet për shtazë, mure të gurit, garazhe dhe anekse, do të pranojnë kompensim në para të gatshme për asetet e tyre. Vlera e këtyre asetëve është ekuivalente me koston zëvendësimit të përkufizuar në **Shtojcën A**.

6.5.8 Humbja e strukturave komerciale

Pronarët e regjistruar dhe të pranuar të strukturave komerciale kanë të drejtë në opsionin e pranimit me kompensim në para të gatshme ekuivalent me vlerën zëvendësuese të strukturës së prekur komerciale (sipas normave të kompensimit të përkufizuara në **Shtojcën A**).

6.5.9 Humbja e veprimtarisë afariste dhe punësimit

Pronarët e bizneseve të prekura nga projekti që mbështeten në përmirësimet e pronave të paluajtshme (struktura, depo, etj.) që ndodhen në Zonën e ndikimit të Projektit kanë të drejtë në njërin opsion të pranimit:

1. Kompensim në para të gatshme ekuivalent me të ardhura neto për gjashtë muaj; apo
2. Kompensim në para të gatshme ekuivalent me të ardhura neto për 12 muaj nëse përfituesi rinis biznes ligjor brenda kufirit administrativ të komunës së Obiliqit.

Pronarët e biznesit duhet të paraqesin dokumentacion të noterizuar të të ardhurave dhe të hyrave të tyre apo shënime të ngjashme.

Punonjësit e bizneseve të prekura nga projekti kanë të drejtë në kompensim në para të gatshme ekuivalent me paga për gjashtë muaj. Sikurse ekonomitë tjera familjare të prekura nga projekti, punonjësit kanë të drejtë të marrin pjesë në Programin për Rikthimin e Mjeteve të Jetesës dhe Zhvillimin e Komuniteteve.

6.5.10 Humbja e të korrurave

KEK-u do të ofrojë kompensim në para të gatshme për të gjitha ndikimet e projektit në të korrura dhe pemët frutdhënëse që gjenden në Zonën e ndikimit të Projektit të cilat janë mbjellë para datës së ndërprerjes së të drejtës.

Pagesa bëhet te përdoruesi/mbjellësi i të korrurave apo pemëve, i cili është ose pronari i regjistruar i pronës në të cilën kultivohen të korrurat apo pemët, ose përdorues i pranuar nga pronari i tokës.

Kompensimi për të korrurat dhe pemët frutdhënëse bazohet në përcaktimet e vlerave të kryera nga agronomë profesionistë gjatë anketës së vitit 2011. Këto përcaktime vlerash marrin parasysh moshën dhe vlerën e plotë produktive të llogaritur gjatë jetës së mbetur ekonomike të pemës.

Ekonomitë e ndikuara familjare kanë të drejtë që korrje-shirjet t'i kryejnë para zhvendosjes, siç është përshkruar në **Pjesën 6.5.12**.

6.5.11 Humbja e qasjes publike

Zhvillimi i minierës do të ndikojë në rrugët ekzistuese publike për qasje si dhe shtigjet joformale, duke përfshirë ato që më herët lidhnin lagjet e Hades dhe Shalës me zonat në perëndim. Për shkak të zhvillimit të fundit të minierës, kjo rrugë më nuk vazhdon për në perëndim të Shalës. Në vend të kësaj, automjetet duhet të ndjekin shtigjet apo rrugët joformale që mirëmbahen dhe kontrollohen nga KEK-u.

Qasja publike në rrugët e mirëmbajtura nga KEK-u do të vazhdojë të jetë në dispozicion, me kufizimet momentale vetëm në banorët lokalë. Rrugët e reja do të zhvillohen gjersa eksploatimi i Fushë së Re të Mihjes dhe mbulimi përkatës avancojnë drejt veriut.

6.5.12 Asistencat dhe lejjimet tjera

KEK-u do t'i ofrojë të drejtat dhe lejjimet shtesë si në vijim për ekonomitë e prekura familjare.

Lejjimet e Mobilizimit/ Rithemelimit

Ekonomitë familjare të zhvendosura nga strukturat e banimit kanë të drejtë në lejjime të mobilizimit dhe rithemelimit në kohën e rivendosjes, të cilat do të kalkuloohen nga MMPH-ja dhe do të prezantohen për diskutime gjatë konsultimeve publike. Ky lejjim ka për qëllim që t'i mbulojë disa nga shpenzimet e ndërlidhura me mobilizimin (paketimin, pronat e riaftësuar, etj.) dhe rithemelimin (shpaketimin, ndërtimin).

Lejjimet në transportim

Ekonomitë familjare të zhvendosura nga strukturat e banimit kanë të drejtë në transportim nga lokacioni i tyre në Shalë te shtëpia e tyre e re, qoftë në fshatin e zhvendosur në Shkabaj qoftë në ato të blera gjetiu (deri në 20 km nga Hadeja). Transportimi do të sigurohet për anëtarët e familjes, përfshirë edhe një ngarkesë të madhe kamioni për mjetet e tyre të lëvizshme, duke përfshirë artikujt e ndryshëm të ekonomisë familjare, materialet e riaftësuar dhe kafshët shtëpiake.

E drejta në riaftësim

Të gjithë personat e prekur nga projekti do të kenë të drejtë në të gjitha materialet e riaftësuar nga prona e tyre para zhvendosjes, me kush që ato të largohen deri në 15 ditë pas njoftimit paraprak para zhvendosjes, të lajmëruar nga KEK-u dhe MMPH-ja. Më pastaj, rrënimi i strukturave dhe asetëve tjera të paluajtshme do të kryhet nga ana e KEK-ut. Të gjitha shpenzimet dhe rreziqet e riaftësimit do të barten nga pala që largon materialin.

E drejta në korrje-shirje

Të gjithë personat e prekur nga projekti do të kenë të drejtë në korrje-shirje të të mbjellave të tyre dhe pemëve frytdhënëse për të cilat kanë siguruar deklaratë të pranuar para zhvendosjes. Sikurse me të drejtën në riaftësim, ekonomive familjare do t'u ofrohet 15 ditë njoftim paraprak para zhvendosjes për korrje-shirjen e të mbjellave.

6.6 Zhvendosja e përkohshme

Zhvendosja duhet të vazhdojë tutje vetëm pasi të jenë finalizuar marrëveshjet individuale dhe pasi të jenë bërë pagesat e kompensimit. Është e mundur – duke pasur parasysh afatet kohore të këtij Projekti – që të arrihen marrëveshje alternative të dislokimit në fshatin e zhvendosjes Shkabaj (për pronaret e kualifikueshem) mes pjesëtarëve të komunitetit, KEK-ut dhe MMPH-së. Duke i pasur parasysh vonesat në planifikimin dhe implementimin e zhvendosjes, ekonomitë e prekura familjare presin me padurim që të përfundojë pritja për zhvendosje dhe të rivendosen në shtëpitë dhe pronat e reja. Megjithatë, parcelat zëvendësuese në Shkabaj mund të mos jenë tërësisht të gatshme për fillimin e ndërtimit menjëherë pas përfundimit të negociatave individuale. Veç kësaj, për ndërtimin e shtëpive duhen disa javë apo muaj, si dhe fillimi i stinës së dimrit mund të ketë ndikim në të. Ngjashëm, edhe KEK-u është në pozitë jo të lehtë duke kërkuar tokën në Zonën e ndikimit të Projektit për t'i vazhduar operacionet pas vjeshtës së vitit 2011.

Perspektiva e zhvendosjes së përkohshme është diskutuar me pjesëtarët e komunitetit të prekur nga projekti për më se një vit. Në pritje të ndikimit potencial, ekonomitë e prekura familjare janë kërkuar që t'i shprehin preferencat e tyre në kuptim të akomodimit të përkohshëm gjatë anketës së vitit 2011 (përgjigjet nuk ishin të obligueshme). 46 nga 63 ekonomi familjare rezidente kanë kërkuar akomodim në banesat në pronë të MMPH-së në Obiliq, nëse ato janë në dispozicion. 16 ekonomi familjare kanë theksuar se do të rregullojnë vetë akomodimin e tyre. 1 ekonomi familjare është përgjigjur se dëshirojnë të qëndrojnë me familjarë.

Nëse ndodh zhvendosja e përkohshme, të gjitha ekonomitë familjare rezidente, që kanë përzgjedhur kalimin në parcela zëvendësuese në fshatin e zhvendosur do të kenë të drejtë në akomodim të siguar nga KEK-u apo, nëse vendosen gjetiu, në lejim të qirasë. Kjo asistencë do të jetë në dispozicion për ekonomitë e kualifikuara familjare deri në 4 muaj pas dhënies së qasjes në parcelat zëvendësuese (për ndërtim) varësisht nga kushtet sezonale. Ekonomitë familjare që zgjedhin të marrin kompenzim financiar dhe kërkojnë akomodim të ri gjetiu, do të kenë të drejtë për shpenzime të qirasë në periudhë prej 4 muajsh.

Ekonomitë familjare që kanë të drejtë në parcelat zëvendësuese në fshat, por që banojnë në strehim të përkohshëm alternativ (jo ato të parashikuara nga MMPH) duhet të tregojnë se kanë marrëveshje formale që vërteton strehimin adekuat të tyre.

Të gjitha ekonomitë familjare që kanë përzgjedhur të kalojnë në parcela zëvendësuese në fshatin e zhvendosur do të kenë të drejtë në deponim të një sasive të kufizuar të materialeve – më saktësisht materiale të riaftësuar dhe materiale ndërtimore – në një depo në afërsi të lokacionit në Shkabaj.

7. ASETET ZËVENDËSUERE

7.1 Synimet

Asetet e zëvendësimit në këtë pjesë janë hartuar në konsultim me njerëzit e prekur nga projekti me qëllim të sigurimit të njerëzve të prekur dhe të kualifikuar për në projekt asetet që u mundësojnë atyre një standard të përmirësuar jetese.

Të gjitha asetet e zëvendësimit paraqesin përmirësime mbi asetet e ndikuara dhe përmbushin standardet dhe rregulloret e Kosovës. Për më tepër, siç përcaktohet nga praktikat më të mira ndërkombëtare, ky plan përfshin masat për përmirësimin e një banimi adekuat dhe kushte të përmirësuara jetese, duke marrë parasysh sigurinë, gjendjen financiare, gjendje e banimit, qasjen dhe infrastrukturën dhe shërbimet e përmirësuara.

Vendndodhja e lokacionit të zhvendosjes në Shkabaj do të ofrojë qasje të vazhdueshme për mjetet e jetesës dhe rrjetet ekonomike dhe sociale, si dhe qasjen e përmirësuar në mundësi punësimi, treg dhe infrastrukturë themelore si ujë, rrymë, kujdes shëndetësor dhe arsim.

7.2 Përzgjedhja e lokacionit dhe procesi i projektimit

KEK dhe MMPH kanë pasur bashkëpunim të ngushtë me ekonomitë familjare të prekura nga projekti dhe me komunën e Obiliqit për identifikimin e një lokacioni të përshtatshëm për zhvillimin e një komuniteti të ri dhe për hartimin e planeve të infrastrukturës dhe komunitetit për këtë lokacion.

Në mënyrë që të përzgjedhin lokacionin më të përshtatshëm për zhvendosje, KEK, MMPH, komuna dhe banorët e fshatit HADE shqyrtuan katër lokacione të mundshme. Këto lokacione janë: Llazareva, Millosheva dhe Shkabaj (për banimin rural) dhe Obiliq (për strehim banesor). Të gjitha lokacionet gjinden në komunën e Obiliqit dhe janë ngjitur me autostradën e re Prishtinë-Mitrovicë, ose në qendër Obiliqit. Në prill të vitit 2004, lokacioni në Shkabaj ishte përzgjedhur ekonomitë familjare të prekura nga projekti dhe ishte miratuara nga Kuvendi Komunal i Obiliqit, ndërsa në maj të vitit 2004 edhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Lokacioni në Shkabaj u përzgjedh, pjesërisht, për shkak të preferencës së komunitetit për banim rural dhe për shkak se lokacioni është afër Prishtinës (5 km).

Plani Rregullativ Urban për Shkabaj u hartua në vitin 2006. Plani përfshinte planin për ndërtesën dhe parcelën, rrugët dhe lëvizjen për këmbësorët, hapësirat publike dhe shërbimet publike. Plani, i hartuar nga MMPH, komuna dhe konsulentët, u shqyrtua nga banorët dhe përfaqësuesit e Shalës gjatë një varg takimesh në mes të vitit 2006. Pas kësaj, në vitin 2007 u përfundua një plan i infrastrukturës. Plani Rregullativ Urban dhe Plani i Infrastrukturës u shqyrtuan dhe miratuan nga komuna e Obiliqit.

Planet për komunitetin u shqyrtuan përsëri me pjesëtarët e komunitetit në mes të vitit 2011, në lidhje me planet për fazën 1, përzgjedhjen e lokacionit, zhvendosjen dhe procedurën e ndërtimit.

Paralelisht me këtë, në verën 2011 e vitit MMPH kontraktoi një firmë kosovare të arkitekturës për hartimin e modeleve për shtëpitë e zhvendosura. Shumica e ekonomive familjare të kualifikuara shprehen preferencën për ndërtimin e shtëpive të tyre zëvendësuese. Skemat për banim u hartuan për të mundësuar marrjen e lejeve për ndërtim dhe për të siguruar një dizajn koherent dhe të cilësisë së lartë për komunitetin e ri. Projekt-planet arkitekturale u paraqitën dhe u diskutuan në korrik të vitit

2011, duke përfshirë diskutimin e brendshëm me komunitetin e ndikuar. Informatat kthyes nga hisedarët rezultuan në përkufizimin e dizajnëve të rishikuar.

7.3 Plani për komunitetin

Planet për komunitetin për fshatin e zhvendosur në Shkabaj paraqitën në **Figurën 7.1**.

Figura 7.1: Plani i Komunitetit për Fshatin e Rivendosjes.

Lokacioni prej 44 hektarë në Shkabaj, siç u identifikua nga KEK-u, MMPH-ja dhe komuna e Obiliqit do të shërbej si lokacion për zhvendosjen e ekonomive familjare fizike gjatë fazave të zgjerimit të minierave në Minierën e Re, duke filluar me lagjen e Shalës. Pas ndërtimit të plotë, komuniteti i ri do të përbëhet prej përafërsisht 1 000 parcela urbane, shkolla dhe çerdhe fëmijësh, qendra shëndetësore, xhami, varreza, qendra sportive dhe rekreative.

Zhvillimi i komunitetit do të fillojë në juglindje të lokacionit, ngjitur me komunitet ekzistues në Shkabaj dhe rrugët ekzistuese, ujësjellësin dhe lidhjen me energjinë elektrike.

7.4 Parcelat e banimit

7.4.1 Dizajni i parcelës

Faza e parë e planit të komunitetit përbëhet prej përafërsisht 250 parcelave të banimit. Përafërsisht 75 parcela do t'iu shpërndahen ekonomive familjare të kualifikuara nga Shala (që do të përcaktohen nëpërmjet konsultimit individual me ekonomitë familjare gjatë muajit gusht të vitit 2011). Përveç kësaj, 105 parcela në Shkabaj do t'iu shpërndahen ekonomive familjare të zhvendosura gjatë evakuimit emergjent në Hade në vitin 2004. Parcelat do t'iu shpërndahen ekonomive familjare të kualifikuara siç përcaktohet në **Pjesën 7.4.2**.

Dimensionet dhe sipërfaqja e parcelave (me mundësi zgjedhjeje ndërmjet 300-450, 450-550 or 550-700 m²) janë të ngjashme me parcelat e porsazhvilluara në Shkabaj dhe në periferi të Obiliqit dhe Prishtinës. Parcelat janë dizajnuar ashtu që të jenë të mjaftueshme për ndërtimin e shtëpive zëvendësuese si dhe për veprimtaritë plotësuese për përdorimin e tokës, duke përfshirë kopshtarinë, magazinimin dhe shtimin e hapësirës së banimit siç kërkohet nga pronari i zhvendosur. Dallimet ndërmjet madhësisë së parcelës do të rezultojnë për shkak të topografisë së lokacionit dhe kufizimeve në dizajn, ndonëse shumica e parcelave janë në mes të 500 m² dhe 700 m².

Këto dimensione të parcelave zëvendësuese janë shumë më të përshtatshme se sa kushtet ekzistuese në Shalë, përfshirë në kuptim të përparësive të lokacionit dhe vlerës përkatëse të tokës. Parcelat ekzistuese të banimit në Shalë janë përafërsisht 450 m² tokë ndërtimore (shumë parcela në Shalë janë përzjerje e tokës ndërtimore dhe tokës bujqësore në një titull prone, siç përkufizohet me kadastrin aktual). Edhe pse parcelat e zakonshme lineare në Shalë më herët posedonin 15 deri në 20 metra të buzërrugës, shtimi dhe nën-ndarja kanë lënë shumë prona dhe ekonomi familjare pa qasje të drejtpërdrejt në rrugë. Në Shkabaj, të gjitha parcelat e reja do të kenë buzërrugë dhe qasje të drejtpërdrejt.

7.4.2 Shpërndarja e parcelave

Gjatë bisedimeve individuale, ekonomitë familjare do të paraqesin preferencat e tyre për madhësinë e parcelës zëvendësuese (700 m², 500 m² or 300 m²).

Pas kësaj, komuniteti i Shalës do ta ketë mundësinë që vetë të menaxhojë shpërndarjen e parcelave zëvendësuese. MMPH do t'iu sigurojë hartat dhe informatat e domosdoshme dhe, nëse paraqitet nevoja, do të lehtësojë bisedimet.

Nëse komuniteti nuk mund të zgjidhë të gjitha rastet e kualifikuara brenda 7 ditëve, atëherë ndarja e parcelave do të bëhet nëpërmjet shortit që administrohet nga MMPH.

Ekonomitë familjare të zhvendosura do të organizohen në tri grupe sipas dimensioneve të parcelës së tyre të preferuar. Nëpërmjet tërheqjes së shortit, parcelat zëvendësuese do t'iu shpërndahen ekonomive familjare.

Shkëmbimi i parcelave ndërmjet banorëve do të bëhet brenda 15 ditëve pas shortit, në mënyrë që t'iu mundësohet miqve apo familjarëve që të jetojnë afër njëri-tjetrit.

7.5 Shtëpitë

MMPH-ja do të mbikëqyrë ndërtimin e shtëpive zëvendësuese në Shkabaj, shumica e të cilave do të ndërtohen nga vetë ekonomitë e kualifikuara familjare.

Gati që të gjitha ekonomitë familjare të kualifikuara kanë shprehur preferencën e tyre për të ndërtuar vetë shtëpitë e tyre zëvendësuese. Ekonomive familjare iu është paraqitur mundësia e marrjes së ndihmës logjistike për ndërtimin e shtëpive, me ç'rast MMPH-ja do të menaxhojë dhe kontraktojë shërbimet e domosdoshme për ndërtim. Ekonomitë familjare gjegjëse do të konfirmojnë qasjen e tyre të preferuar gjatë bisedimeve individuale.

Për familjet që kanë marrë përsipër ndërtimin e shtëpive të zëvendësuarat e tyre, do të duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre për leje ndërtimi në komunë.

Për të siguruar që shtëpitë zëvendësuese kanë madhësinë, materialin dhe shkallën e mirëfilltë të kompletimit, si dhe që janë në përputhje me lejen komunale, MMPH-ja ka pagatitur një varg të modeleve për shtëpitë.

Modelet kanë qenë temë e diskutimit të gjerë me dhe brenda komunitetit dhe janë rishikuar për t'iu përshtatur më mirë aranzhimeve të jetesës për ekonomitë familjare të zhvendosura. Si pjesë e bisedimeve individuale, ekonomitë familjare të kualifikuara do të përzgjedhin modelin e tyre të preferuar të ndërtesës para dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe para fillimit të ndërtimit të shtëpive.

Shtëpitë zëvendësuese do të kenë dy nivele me, sipas përzgjedhjes, një kat kryesor ose bodrum.

Shtëpitë zëvendësuese që do të ndërtohen në fshat kanë përparësi ndaj atyre ekzistuese. Të gjitha shtëpitë do të kenë ndërtim të izoluar, instalime elektrike sipas standardeve apo më mirë; furnizim më të mirë me ujë të klorifikuar dhe me presion; dhe tualetet do të jenë të lidhura me sistemin e trajtimit të ujërave të zeza.

7.6 Ndërtesat komerciale

Ashtu si edhe me ndërtesat e banimit, edhe ndërtimi i ndërtesave komerciale do të bëhet nga vetë ekonomitë familjare ose nga MMPH-ja, pra varësisht nga preferencat dhe mjetet e ekonomive familjare.

Plani dhe lokacioni i ndërtesave komerciale duhet të kenë leje ndërtimi nga komuna e Obiliqit dhe duhet të jenë të përputhje me Planin Urban Rregullativ për fshatin Shkabaj.

7.7 Ndërtesat institucionale

Aktualisht, asnjë ndërtesë institucionale nuk gjendet në lokacionin e zonës së ndikimit të projektit. Komuniteti i ri në Shkabaj do të ketë një shkollë dhe çerdhe, një qendër mjekësore, xhami, varreza si dhe hapësira publike dhe parqe.

Këto do të ndërtohen në bashkërendim me zhvillimin e lokacionit dhe janë të dizajnuara për t'i shërbyer popullsisë së komunitetit pas ndërtimit të plotë.

7.8 Infrastruktura e komunitetit

KEK-u dhe MMPH-ja do të sigurojnë infrastrukturën e domosdoshme për komunitetin e zhvendosur në Shkabaj. Plani i përgjithshëm i sistemeve të infrastrukturës zëvendëson infrastrukturën ekzistuese në zonën e ndikimit të projektit, duke përmirësuar standardin e cilësisë.

Planet e infrastrukturës janë në përputhje me standardet dhe praktikat e Kosovës, me mundësi përmirësimi kurdoherë që është e mundshme.

Rrugët dhe trotualet do të stabilizohen me zhavorr të duhur për shtrimin e rrugëve (i planifikuar për vitin e dytë të ndërtimit të fshatit të zhvendosur). Rrugët në komunitetin e zhvendosur do të lidhen me rrjetin e rrugëve ekzistuese në Shkabaj dhe ndoshta edhe me autostradën Prishtinë-Mitrovicë. Të gjitha rrugët do të kenë kanale drenazhi të kapacitetit të duhur për të thithur ujerat.

Komuniteti i zhvendosur do të lidhet me ujë të pijshëm në shkallë komuniteti dhe me sistemet ujore sanitare. Sistemi do të përfshijë lidhjen e shtëpive me një kanal të madhësisë standarde për ujërat e mbetura që do të lidhet me një fabrikë për trajtimin e ujërave të mbetura. Pronarët pritet të paguajnë shërbimet komunale për konsumimin e tyre të ujit në Shkabaj, për dallim të marrëveshjes së tanishme për Shala.

Përfundimisht, në lidhje me energjinë elektrike komuniteti i zhvendosur do të lidhjet me rrjetin lokal të energjisë elektrike. KEK-u do të mundësojë këtë lidhje nëpërmjet një nën-stacioni të ri. Energjia elektrike do të shpërndahet nëpërmjet një rrjeti të kabllos ajrore për secilin përdorues.

7.9 Dorëzimi (funksionimi dhe mirëmbajtja)

Funksionimi dhe mirëmbajtja e aseteve zëvendësuese janë thelbësore për qëndrueshmërinë afatgjate të fshatit të zhvendosur.

KEK do t'iu sigurojë ekonomive familjare të zhvendosura titujt ligjor për asetet zëvendësuese në kohën e marrëveshjes dhe pasi që të përfundojë ndërtimi i infrastrukturës bazike dhe i punimeve tokësore do të lejojë qasjen në tokë në Shkabaj.

KEK-u dhe MMPH-ja do të punojë me ekonomitë familjare të prekura nga projekti dhe komunën e Obiliqit për të përcaktuar procedurat realiste dhe të mbështetura mirë të funksionimit dhe mirëmbajtjes së aseteve të reja në fshatin e zhvendosur, duke përfshirë rrugët, sistemet e ujit të pijshëm, kanalizimin dhe fabrikat për trajtimin e mbeturinave. Diskutimet e ngjashme do të adresojnë çështjet në lidhje me arsimin dhe qasjen në shërbimet sociale dhe hapësirat e tjera të komunitetit. Ndërtimi dhe hyrja në funksion e Shkolles, Qendres së Shendetit dhe Xhamise do të planifikohet në bashkëpunim me Ministrinë, agjensitë dhe kompanitë perkatese. Këto procedura duhet të përkufizojnë përgjegjësitë financiare dhe afatet kohore gjegjëse për të gjithë partnerët, duke përfshirë edhe KEK-un.

Ky plan i dorëzimit duhet të hartohet për të përmbushur këto synime:

- Shmangien e çfarëdo lloji të varësisë nga ndërtimet e tjera të KEK-ut apo të qeverisë;
- Garantimin e asaj që kostoja e funksionimit dhe mirëmbajtjes së aseteve zëvendësuese është e qëndrueshme për ekonomitë familjare të zhvendosura.

Përgjegjësitë e secilit pronar shtëpie janë si ato të qyteteve të organizuara, siç janë pagesa e taksës mbi pronë dhe pagesa e shërbimeve infrastrukturore për ujë, kanalizim dhe energji elektrike. Ekonomitë familjare do të bartin vetë këto shpenzime, pra në mënyrë të pavarur nga ky PVZh.

8. RIKTHIMI I MJETEVE TË JETESËS DHE ZHVILLIMI I KOMUNITETIT

8.1 Udhëzimet e IFC-së

Udhëzimet e IFC-së thonë që 'rikthimi i thjeshtë i mjeteve të jetesës mund të jetë i pamjaftueshëm për të mbrojtur popullatën e prekur nga ndikimet negative të projekteve, veçanërisht efektet e *nxitura* si konkurrenca për burime dhe punësim, inflacioni, dhe shthurja e rrjeteve të përkrahjes sociale. Për këtë arsye, IFC mëton që të promovojë *përmirësimin* e standardeve të jetesës për personat e prekur nga projekti”.

8.2 Objektivat

Një sërë nismash të për rikthimin e mjeteve të jetesës dhe zhvillimit të komunitetit janë duke u zhvilluar si pjesë e programit të zhvendosjes për lagjen e Shalës.

Të dhënat bazike socio-ekonomike të mbledhura në maj dhe qershor të vitit 2011 japin bazën për planifikim për programet e mjeteve të jetesës. Mundësitë për punësim tashmë janë zgjeruar te një pjesë e madhe e popullatës së Shalës, sipas marrëveshjes me përfaqësuesit e kësaj popullate në vitin 2011. Konsultimet me ekonomitë e prekura familjare lidhur me mjetet aktuale të jetesës dhe perspektivën për të ardhmen janë planifikuar për muajt në vijim me qëllim të zgjerimit të aktiviteteve të rikthimit të mjeteve të jetesës në sektorë të ndryshëm dhe për të gjitha ekonomitë familjare.

Nismat për rikthim të mjeteve të jetesës dhe zhvillim të komunitetit synojnë që t'i ndihmojnë ekonomitë familjare të prekura nga projekti që t'i rivendosin mjetet e tyre të jetesës – apo të krijojnë mjete të reja të jetesës – dhe të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të jetesës në formë të përfitimeve zhvillimore afatgjata.

Objektivat më specifike përfshijnë këto si në vijim:

- Ndhmën për anëtarët e ekonomive familjare të prekura nga projekti për rivendosjen e mjeteve të jetesës apo për krijimin e mjeteve të reja të jetesës;
- Promovimin e pjesëmarrjes së ekonomive familjare të prekura nga projekti në mundësitë e punësimit që do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të PVZH-së dhe gjatë zhvillimit dhe realizimit të projektit;
- Sigurimin e përfitimeve zhvillimore afatgjata për ata që pranojnë kompensim në para;
- Shtimin e arritshmëri në arsimim të personave të prekur nga projekti, përfshirë të rriturit dhe fëmijët
- Përmirësimi i kushteve si mjet për promovimin e gjendjes më të mirë të shëndetit të përgjithshëm të personave të prekur nga projekti
- Ndhmon ekonomive familjare të zhvendosura në krijimin, operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të tyre të zhvendosjes dhe atyre të komunitetit të zhvendosur në përgjithësi

9. NDIHMA PËR GRUPET E CENUESHME

9.1 Cenueshmëria

IFC i përkufizon personat e cenueshëm si persona të cilët, “për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, koshës, paaftësisë fizike dhe mendore, gjendjes së pafavorshme ekonomike, apo gjendjes sociale, mund të preken më tepër nga zhvendosja se sa tjerët dhe të cilët mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të kërkuar apo për të përfituar nga ndihma e zhvendosjes dhe përfitimet e ndërlidhura zhvillimore”.

Cenueshmëria mund të shihet në kontekst të dy fazave:

- Cenueshmëria që ka ekzistuar më parë; dhe
- Cenueshmëria ose mundimet transicionale të shkaktuara nga zhvendosja fizike dhe ekonomike që ndërlidhet me projektin.

Cenueshmëria që ka ekzistuar para projektit është cenueshmëri që ekziston me apo pa zhvillimin e projektit. Cenueshmëria e shkaktuar nga zhvendosja fizike dhe ekonomike që ndërlidhet me projektin, ndodhë si rezultat i atyre që janë të prekur drejtpërsëdrejti nga projekti të cilët nuk janë në gjendje që t'i përshtaten kushteve të reja të shkaktuara nga ndikimet negative që ndërlidhen me aktivitetet e projektit. Ky lloj i cënueshmërisë mund t'i prekë personat që nuk kanë qenë të cenueshëm më parë; mirëpo, ata tek të cilët ka ekzistuar cenueshmëria edhe më parë kanë shumë më shumë gjasa që të gjenden në pozitë të pafavorshme nga ndikimet e projektit.

Për qëllime të kësaj PVZH-je, personat e cenueshëm përkufizohen në pajtim me përkufizimin e dhënë më lart nga IFC-ja.

9.2 Cenueshmëria në zhvendosje

Zhvendosja jo-vullnetare, nëse nuk menaxhohet si duhet mund të shpie në varfërim të ekonomive të prekura familjare. Përvoja ndërkombëtare me zhvendosjet jovullnetare tregon që rreziqet kryesore që shpien në varfërim si rezultat i drejtpërdrejtë i procesit të zhvendosjes janë:

- Humbja e tokës – humbja e pakthyeshme e aseteve tokësore, përfshirë pronën e përbashkëta;
- Papunësia – humbja e vendeve të punës dhe tregjeve;
- Humbja e shtëpisë – humbja e strehimit;
- Margjinalizimi – humbja e fuqisë ekonomike dhe pozitës sociale që rezulton në zvogëlim të statusit socio-ekonomik;
- Pasiguria e ushqimit;
- Rritje e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë;
- Humbja e qasjes në burimet e përbashkëta pronësore;
- Shthurja sociale – rrjetet e penguara sociale dhe humbja e kapitalit social; dhe
- Ndërprerja e arsimit.

Një realitet i zhvendosjes është që disa nga rreziqet e përmendura më lart shpesh realizohen njëkohësisht, duke e acaruar kështu gjendjen e rëndë ekzistuese dhe krijimin e varfërisë së serishme.

Disa kategori të caktuara të personave janë njohur si veçanërisht të cenueshme ndaj pengesave:

- Të varfrit/të pastrehët.
- Qiramarrësit/gjysmatarët/punëtorët e fermave që nuk kanë pronë tokësore/ara apo ndërtesa në pronësinë e tyre.
- Ekonomitë familjare me persona të hendikepuar, të sëmurë kronik, apo të stigmatizuar nga shoqëria.
- Nënata e pamartuara.
- Personat e vjetër, të vejat dhe vejanët që nuk jetojnë me fëmijë të rritur.

9.3 Planifikimi për cenueshmëri

Në përgatitjen e këtij PVZh, është shqyrtuar cenueshmëria e nivelit të lartë të ekonomive familjare individuale të prekura nga projekti, duke marrë për bazë informatat nga treguesit e cenueshmërisë, të dhënat nga baza socio-ekonomike të mbledhura nga hulumtimet e vitit 2011, konsultimet në nivel të komunitetit dhe konsultimet sy me sy.

Rreziqet janë identifikuar dhe ndërlidhen me cenueshmërinë që ka ekzistuar më parë (që del nga dinamika ekzistuese socio ekonomike apo gjendja e ekonomive familjare) si dhe vështirësitë transicionale (që dalin nga vetë procesi i zhvendosjes).

Masat për të ndihmuar personat e cenueshëm janë duke u zhvilluar si përgjigje ndaj rreziqeve që kanë ekzistuar më parë dhe atyre transicionale. Këto masa do të përfshijnë masa para zhvendosjes, masa gjatë zhvendosjes dhe masa pas zhvendosjes. Shumë masa para dhe gjatë zhvillimit për shmangien e cenueshmërisë së nxitur nga projekti dhe për zbutjen e saj, tashmë janë futur në këtë PVZH, si ato të paraqitura në Kornizën e Kompensimit për banim të të zhvendosurve, rivendosjen e ndihmës dhe zhvendosjes së përkohshme.

Zbatimi i masave për ndihmën për personat e cenueshëm do të përfshijë edhe monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e çështjeve të cenueshmërisë gjatë fazës pas zhvendosjes. Treguesit e cenueshmërisë për ekonomitë familjare individuale – dhe për komunitetin në përgjithësi – do të gjurmohen për të parë ndryshmet nga niveli bazë i vitit 2011. Masa korrigjuese dhe apo masa ndihmëse mund të bëhen pas kësaj.

10. MENAXHIMI I ANKESAVE

10.1 Udhëzim i IFC-së

Një udhëzimi i IFC-së thotë që “pavarësisht nga masa dhe niveli i planifikimit, zhvendosja e pavullnetshme pashmangshëm ngritë ankesa nga popullata e prekur. Shqyrtimi me kohë i këtyre ankesave është jetik për zbatim të kënaqshëm të zhvendosjes dhe për realizim të projektit me kohë”.

10.2 Aplikueshmëria

Mekanizmi për menaxhimin e procedurave të ankesave lidhur me projektin vlen për të gjitha ankesat e pranura nga komunitetet e prekura nga projekti dhe apo individët dhe do të përdoret nga ekipi i projektit në MMPH për të menaxhuar zgjidhjen e atyre ankesave.

Ankuesit do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të respektueshme. Ankuesi i ka të gjitha të drejtat që burojnë nga ligjet e Kosovës për apelim në çfarëdo instance të lejuar nga Kushtetuta për zgjidhje.

10.3 Mekanizmi për menaxhimin e ankesave

Në vitin 2010 MMPH-ja ka krijuar një komision për ankesa, për të trajtuar ankesat lidhur me programin e zhvendosjes së lagjes Shala. Komisioni udhëhiqet nga shefi i zyrës ligjore të MMPH-së ku përfshihet edhe një jurist dhe një inxhinier nga Zyra e projektit në Hade, një këshilltar të ministrit dhe një zyrtar për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut.

Ankesat mund të parashtrohen nga cilido individ apo grup i individëve që ka ndonjë brengë apo ankesë lidhur me programin e zhvendosjes, përfshirë ndikimet e aktiviteteve aktuale apo të planifikuara të projektit, saktësinë e të dhënave lidhur me asetet dhe aktiviteteve të anëtarëve të ekipit.

Ankesat mund të parashtrohen në njërin nga tri mënyrat: personalisht, me shkrim, apo përmes telefonit. Ankesat mund të pranohen nga personeli i MMPH-së në terren apo në zyrat në Prishtinë. Ankesat regjistrohen nga personeli i zyrës së projektit Hade në regjistër dhe u caktohet një numër i dosjes.

Ankesat shqyrtohen nga Komisioni pas grumbullimit të një numri prej 15-20 ankesash apo çdo 15 ditë, cilado që të ndodhë e para. Në konkluzion të procesit të shqyrtimit, shënimet e vendimit iu dërgohen palës ankuese.

Vendimi mund të shpejtoj veprime korigjuese nga ana e Zyrës së Projektit Hade ose departamentet e tjera relevante në MMPH dhe KEK-ut.

Në rastet kur ankuesi nuk është i kënaqur me zgjedhjen e propozuar, ankuesi është plotësisht në kuadër të të drejtave të tij për të ndjekur çështjen në sistemin gjyqësor të Kosovës.

10.4 Përmbledhje e ankesave të parashtruara deri më sot

Mekanizmi i menaxhimit të ankesave është përdorur në menyrë aktive nga banorët që kanë pasë ankesa. Deri më Shtator 2011, Komisioni për Ankesa në MMPH ka regjistruar më shumë 50 ankesa të pranueshme. Shumica e ankesava ka të bëjë me incizimin e pronës dhe paknaqësinë në nivelin e kompenisimit. Shqyrtimi i fundit i ankesave vshtë bërë në javën e 5 Shtatorit nga Komisioni.

11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

11.1 Udhëzimet e IFC

IFC kërkon që sponsoruesit e projekti të "monitorojnë dhe raportojnë lidhur me efektivitetin e implementimit të PVZH. Qëllimi duhet të jetë që [sponsoruesi i projektit] të sigurojë informata dhe t'i identifikojë problemet dhe sukseset sa më herët që është e mundur që të mundësohet rregullimi me kohë i aranzhimeve të implementimit".

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të "integrohen në procesin e përgjithshëm të menaxhimit, si dhe PVZH duhet të ofrojë një plan koherent të monitorimit i cili identifikon përgjegjësitë organizative, metodologjinë dhe planin kohor për monitorim dhe raportim".

11.2 Pasqyrë

Projekti do të kryejë monitorim dhe vlerësim për të përcjellë implementimin e këtij RAP. Monitorimi dhe vlerësimi do t'i kushtojnë vëmendje të posaçme ndryshimeve në kushtet socio-ekonomike dhe kushteve të jetës të ekonomive të prekura familjare, posaçërisht grupeve të cenueshme. Monitorimi do të kryhet nga KEK-u si dhe nga një konsulent i pavarur i cili do të punojë për së afërmi me personat e prekur nga projekti. Vlerësimi do të kryhet nga një konsulent i pavarur i zhvendosjes.

Monitorimi dhe vlerësimi do t'i ofrojnë KEK-ut dhe personave të prekur nga projekti informata si në vijim:

- Nëse kompensimi, zhvendosja dhe investimet zhvillimore janë duke shkuar sipas planit;
- Nëse janë duke u trajtuar si duhet ankesat; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet korigjuese.

11.3 Monitorimi

Monitorimi do të bëhet nga:

- Monitorimi i brendshëm nga KEK-u si pjesë e rregullt e menaxhimit të punëve, siç janë menaxhimi i shpenzimeve dhe buxhetit, dhe;
- Monitorimi i jashtëm nga palët e treta/ekspertë të jashtëm që punojnë drejtpërsëdrejti me komunitetet e ndikuara.

Ekonomitë familjare të prekura nga projekti do të marrin pjesë në aktivitete e monitorimit dhe vlerësimit në baza mujore gjatë ndërtimit dhe rivendosjes së fshatit të zhvendosur.

Për përcjelljen dhe monitorimin e procesit të Zhvendosjes do të përdoren një varg indikatorësh. Këta përfshijnë

- Indikatorët e inputit që matin kohën dhe resurset e përdorura për të kryer PVZH-në (d.m.th. shpenzimet e zhvendosjes, trajnimet dhe programet e zhvillimit ekonomik);
- Indikatorët e procesit që matin se si po ecën projekti (d.m.th. orari kohor i aktiviteteve; efektiviteti i mekanizmave të angazhimit); dhe

- Indikatorët e ndikimit që matin ndikimet përfundimtare të PVZH dhe aktiviteteve të mihjes.

Indikatorët kyçë të performancës do të identifikohen nga KEK-u dhe MMPH në konsultim me ekonomitë familjare të prekura nga projekti. Indikatorët për monitorim mujor do të adresojnë:

- Aktivitetet dhe pjesëmarrjen në konsultime;
 - Numri i konsultimeve formale të mbajtura
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e konsultimeve
 - Numri i grave pjesëmarrëse në konsultime
- Menaxhimin e ankesave;
 - Numri i ankesave të regjistruara nga KEK apo nga MMPH
 - Numri i ankesave të zgjidhura apo të mbyllura
 - Rezultati i ankesave në përqindje
- Pjesëmarrjen në rikthimin e mjeteve të jetesës dhe programin për zhvillimin e komunitetit;
 - Numri i ekonomive familjare apo individëve të cilët marrin pjesë në programet për zhvillimin e komunitetit
- Nivelet e punësimit dhe qasjen në të;
 - Shkalla e pjesëmarrjes
 - Shkalla e papunësisë
 - Përqindja e shtëpive të cilat nuk kanë asnjë të punësuar
 - Numri i personave të prekur të cilët punojnë në KEK.
- Mjetet tokësore të jetesës dhe qasjen në tokë;
 - Përqindja e shtëpive që përdorin tokën për jetesë apo për ndonjë aktivitet komercial
- Krijimin e ndërmarrjeve të vogla afariste;
 - Numri i bizneseve të vogla të menaxhuara nga personat të ndikuar nga projekti
- Kapitalin financiar (të ardhurat dhe shpenzimet);
 - Burimet e të ardhurave primare në ekonomi familjare
 - Të ardhurat mujore në ekonomi familjare, sipas kategorisë
 - Harxhimet mujore në ekonomi familjare, sipas kategorisë
- Shëndetin dhe sigurinë;
- Kohezionin e komunitetit;
- Kushtet e banimit dhe infrastrukturë;
 - Numri i banorëve që jetojnë në komunitetin e ri (përfshirë banorët për shtëpi)
 - Numri i shtëpive të përfshirë në rrjetin e ujësjellsit dhe kanalizimit
- Shpenzimet e mirëmbajtjes; dhe
- Nivelin e kënaqësisë së personave të prekur nga projekti.

Monitorimi i ndikimit nga konsulenti i jashtëm do të përqendrohet në shkallën në të cilën, si rrjedhojë e projektit, janë ndikuar, rivendosur apo përmirësuar mjetet e jetesës, standardi i jetesës dhe mirëqenia e përgjithshme e personave të prekur.

11.4 Vlerësimi

Vlerësimet tremujore do të kryhen për të përcaktuar:

- Pajtueshmërinë e implementimit të PVZH me ligjet, rregulloret dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të aplikueshme; dhe
- Ndikimi i zhvendosjes në standardin e jetesës së ekonomive të prekura familjare.

Vlerësimet do të kryhen nga një konsulent i pavarur i zhvendosjes i përzgjedhur me kujdes në bazë të përvojës praktike dhe aftësisë së dëshmuar për të ofruar rekomandime të dobishme.

12. ORGANIZIMI

Zyra e Projektit Hade është autorizuar nga Qeveria që të udhëheqë, bashkë me KEK-un dhe në konsultime me familjet e prekura nga projekti, menaxhimin e ditor të programit të zhvendosjes dhe përgatitjen e Planit të Veprimit të Zhvendosjes. KEK si propozues i projektit, është përgjegjës për përgatitjen dhe implementimin e këtij Plani të Veprimit për Zhvendosje, me asistencë të vazhdueshme nga zyra e Projektit Hade bashkë me konsulentët e jashtëm. Së bashku KEK-u dhe MMPH përbëjnë ekipin e zhvendosjes.

Të gjitha vendimet madhore për kompensimin dhe rivendosjes shqyrtohen nga një komision ndërministror që përfshinë drejtorët nga KEK, MMPH, MF dhe Komuna e Obiliqit

Departamenti Ligjor në KEK është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e implementimit të këtij plani, me asistencë nga departamente tjera të KEK-ut, ministritë përkatëse qeveritare dhe konsulentët e jashtëm.

Ekipi i zhvendosjes përfshin stafin si në vijim:

- Menaxheri i Projektit të Zyrës së Projektit Hade, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgatitjes dhe implementimin e PVZH-së si dhe prezantimet specifike para komunitetit të prekur nga projekti, negociatat individuale dhe aktivitetet specifike për implementim
- Inxhinierë, juristë dhe agronomë të Zyrës së Projektit Hade, të cilët do të udhëheqin PVZh-në duke përfshirë aktivitete të anketimit, përcaktimit të vlerës, menaxhimit të ankesave dhe marrëdhënieve me komunitetin lokal.
- Konsulentë të zhvendosjes (rePlan), të cilët, krahas Zyrës së Projektit Hade, janë përgjegjës për përgatitjen dhe implementimin e dokumentit PVZH, pajtueshmërisë së tij me rregulloret vendore dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, si dhe për aktivitetet fillestare të monitorimit dhe vlerësimit.
- Departamenti ligjor në KEK, i cili është përgjegjës për përmbylljen dhe përmbylljen e marrëveshjeve me ekonomitë familjare të prekura nga projekti për sa i përket kompensimit, banimit dhe masave tjera të asistencës.
- Zyra e PATEL-it, të cilët janë mbikëqyrës për implementimit e kontratës së projektit.

KEK do të bashkëpunoj me konsulentët arkitekturorë dhe të inxhinierisë, si dhe kontraktuesit e ndërtimit që do të luajnë rol në implementim në lidhje me ndërtimin e fshatit.

13. ORARI

Programi i zhvendosjes për Shalën mund të ndahet në dy komponentë:

- Planifikimi dhe Përgatitja e PVZH; dhe
- Implementimi i PVZH-së.

Planifikimi për zhvendosje ka filluar më 2004 me themelimin e Zyrës së Projektit Hade në MMPH.

Pikat tjera të arritjes gjatë kësaj periudhe kohore përfshijnë:

- Shpallja Zonë Interesi Nacional e Mihjes së Re (2004)
- Përzgjedhjen e ekonomive familjare të prekura nga projekti të lokacionit në Shkabaj për ndërtimin e fshatit të zhvendosur (prill 2004)
- Aprovimi i Planit Urban Rregullativ për fshatin e zhvendosjes (2006)
- Kërkesa e KEK-u për fillimin e procedurave të shpronësimit (2008)
- Vendimi i Qeverisë Nr. 08/66 për fillimin e planifikimit të procesit të shpronësimit (Maj 2009)
- Themelimi i komisionit për menaxhimin e ankesave (2010)
- Bartja e lokacionit të fshatit të zhvendosjes në MMPH (2011)
- Realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, anketës socio-ekonomike dhe inventarit të pasurive (maj-qershor 2011)
- Konsultimet e hapura për shqyrtimin e kornizës së të drejtave, skicave teknike për fshatin e zhvendosjes dhe planin kohor dhe procedurat për zhvendosje (qershor-gusht 2011)
- Miratimi qeveritar i Kornizës së Politikave të Zhvendosjes për Fushën e Re të Mihjes (korrik 2011)
- Përmbledhja e Planit të Veprimit për Zhvendosje duke pasë parasysh rishikimin dhe komentet e pranuar (gusht 2011)
- Takimet me çdo familje të prekur të projektit për të rishikuar të dhënat që kanë të bëjnë me pasuritë e tyre, të drejtat dhe mundësitë e rivendosjes (gusht 2011)
- Finalizimi i Planit të Veprimit për Zhvendosje pas komenteve të marra (dhejtor 2011)

Implementimi i PVZH-së është duke vijuar dhe do të shtrihet përtej zhvendosjes së ekonomive familjare të kualifikuara në fshatin e ri të zhvendosjes në Shkabaj. Pikat kryesore të arritjes në procesin e implementimit përfshijnë (aty ishte e mundur janë dhënë datat e planifikuara/pritura):

- Konsultimet që kanë të bëjnë me rikthimin e mjeteve të jetesës dhe nismat për zhvillim të komunitetit dhe masat e ndihmës për grupet e cenueshme (shtator 2011 - vazhdon)
- Nënshkrimi dhe përmbartimi i marrëveshjeve me ekonomi familjare individuale, duke përfshirë dërgesat e të gjitha të drejtave në kompensim në para të gatshme dhe në natyrë (shtator 2011)
- Përgatitjen e lokacionit të zhvendosjes për ndërtim, përfshirë punimet tokësore, rrugët, drenazhin, kontrollet mjedisore, shërbimet në parcela dhe sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimit (dhjetor 2011- vazhdon)
- Qasja në tokat ku do të bëhet ndërtimi i shtëpive të zëvendësuar
- Zhvendosja e të gjitha përdorimeve aktuale të tokës nga Zona e ndikimit të Projektit
- Implementimi i rikthimit të mjeteve të jetesës dhe nismave për zhvillim të komunitetit
- Implementimi i programit të monitorimit dhe vlerësimit
- Implementimi i masave të ndihmës për grupet e cenueshme
- Konsultimet e vazhdueshme me mbarë komunitetin në lidhje me programin e angazhimit të hisedarëve në fazën e implementimit (shih **Kapitullin 5**).

14. BUXHETI

Të gjitha shpenzimet financiare të zhvendosjes do të barten nga KEK-u, përveç në rastet kur përgjegjësia financiare është caktuar te MMPH-ja me dekret qeveritar.

Të gjitha kompensimet e pagesave do të bëhen njëkohësisht me bartjen e titujve pronësorë dhe nënshkrimet e vlefshme të dokumentacionit tjetër të nevojshëm.

Të gjitha vlerësimet e shpenzimeve të zhvendosjes do të përshtaten në baza tremujore duke marrë parasysh inflacionin dhe luhatjet në valutë. Në fillim të Projektit do të ndahen fonde për t'i mundësuar pagesat e të gjitha shpenzimeve të monitorimit gjatë tërë kohëzgjatjes së procesit të monitorimit të zhvendosjes.

Gjithsej buxheti i ndërlidhur me Implementimin e PVZH-së është si në vijim:

Gjithsej buxheti = € 13,313,300

“Kompensimi për tokë” përfshin shpenzimet e ndërlidhura me kompensimin për humbje në natyrë dhe në para të gatshme të tokës. Më saktësisht, ai përfshin shpenzimet e kompensimit në natyrë (d.m.th. blerja e tokës zëvendësuese) si dhe kompensimin në para të gatshme për personat e kualifikuar (d.m.th., blerja dhe kompensimi i tokave të prekura nga projekti me para të gatshme). Kjo pikë mbulon edhe shpenzimet e ndërlidhura me blerjen e tokave shtesë të nevojshme për komunitetin e zhvendosur urban për infrastrukturë dhe stabilimente (d.m.th. lokacioni i zhvendosjes Shkabaj).

“Kompensimi për të korrura” i referohet kompensimit në para të gatshme për humbjen e të korrurave.

“Kompensimi për struktura” përfshin shpenzimet e ndërlidhura me kompensimin për humbje të strukturave në natyrë dhe në para të gatshme. Më saktësisht, ai përfshin shpenzimet e kompensimit në para të gatshme të personave të kualifikuar (d.m.th., blerjen e strukturave të prekura me para të gatshme) si dhe kompensimit në natyrë (d.m.th., ndërtimit të strukturave zëvendësuese në komunitetin e zhvendosjes), nëse aplikohet.

“Përfitimet tjera” përbëhen nga shpenzimet e lejimit për mobilizim dhe rithemelim për të gjitha ekonomitë familjare të zhvendosura fizikisht, shpenzimet e transportit për të gjitha ekonomitë e prekura familjare, shpenzimet e zhvendosjes së përkohshme (nëse aplikohet), shpenzimet e Rikthimit të Mjeteve të Jetesës dhe Planit për Zhvillim të Komuniteteve, shpenzimet për Planin për Ndhimë të Grupeve të Cenueshme, si dhe shpenzimet e Planit të Monitorimit dhe Vlerësimet.

“Ndërtimi i lokacionit të zhvendosjes” mbulon shpenzimet e ndërlidhura me përgatitjen e tokës dhe ndërtimit të infrastrukturës dhe stabilimenteve të nevojshme në fazën e parë në fshatin e zhvendosjes.

“Administratë” i referohet pagesave për kryerjen e aktiviteteve të implementimit, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve individuale të ekonomive familjare, menaxhimit të infrastrukturës dhe ndërtimit të shtëpive në lokacionin e zhvendosjes, si dhe implementimin e planeve për komponentë të ndryshëm të përshkruar më lartë.

Pika Rezervë mbulon tejkalmimet e mundshme buxhetore në të ardhmen. Ai është vlerësuar në 10% të shumës totale të pikave më lartë.